



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 2/2021 regjistër (JD)
Datë 26.03.2021

Nr. 3 vendimi
Datë 07.12.2022

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji i Posaçëm i Apelit i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Albana Shtylla	Kryetare
Ina Rama	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë plenare publike, në datat 13.12.2021, 17.01.2022, 15.02.2022, 11.03.2022, 27.09.2022 dhe 5.10.2022, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit Disiplinor (JD) nr. 2/2021, datë 26.03.2021, që u përket:

ANKUES: **MARKELIAN KUQO**, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, asistuar me deklaram nga avokate Marçela Kuqo.

SUBJEKTE TË

INTERESUARA: **KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**, përfaqësuar me autorizim nga z. Qemal Zaimi;
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË, përfaqësuar me autorizim nga znj. Isida Koka dhe znj. Alma Troshani.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 633, datë 10.12.2020, “Për caktimin e masës disiplinore ndaj gjyqtarit Markelian Kuqo”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Rivendosja e të drejtave të kufizuara prej kësaj vendimmarrjeje.

BAZA LIGJORE: Neni 4, pika 3, neni 131, shkronja “f”, neni 134, pika 1, shkronja “i”, neni 140, pika 2, shkronja “a”, neni 179, pika 7 e Kushtetutës; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; neni 5, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar; ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 100, pika 1 e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT,

pasi shqyrtoi pretendimet e ankuesit Markelian Kuqo, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Ina Rama, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Ankuesi Markelian Kuqo ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.
2. Ministri i Drejtësisë, nëpërmjet shkresës me nr. {***} prot., datë 20.02.2019, ka paraqitur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor një ankesë ndaj magjistratit Markelian Kuqo. Sipas ministrit të Drejtësisë, ankuesi, gjatë veprimtarisë së tij si gjyqtar, ka ndërmarrë veprime/mosveprime që lidhen me mosrespektimin e përsëritur të legjislacionit procedural e material, zbatimin e gabuar të legjislacionit procedural e material, kur konstatohet nga një gjykatë më e lartë, si dhe parashtrimin e shtrembëruar në mënyrë të dukshme të fakteve dhe rrethanave.
3. Me shkresën nr. {***} prot., datë 19.02.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”) ka përcjellë ankesën e ministrit të Drejtësisë për kompetencë trajtimi pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “ILD”), ankesë e cila është regjistruar pranë këtij institucioni me nr. {***} prot., datë 25.02.2020.
4. Me vendimin nr. {***} prot., datë 02.04.2020, ILD-ja ka vendosur fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit Markelian Kuqo. Në datën 03.08.2020, pranë KLGj-së është depozituar kërkesa e ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor ndaj ankuesit.
5. KLGj-ja, me vendimin nr. 633, datë 10.12.2020, në kuadër të procedimit disiplinor nr. 1/2020, ka vendosur: *1. Pranimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. 2. Shkarkimin nga detyra të magjistratit Markelian Kuqo, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë. 3.*

Pezullimin e përfitimit të pagës në masën 50%, si dhe përfitimet e tjera të magjistratit Markelian Kuqo, deri kur ky vendim të marrë formë të prerë. 4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit në Gjykatën Kushtetuese, afati i të cilit fillon nga e nesërmja e njoftimit të arsyetimit të këtij vendimi. 5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

6. Vendimi nr. 633, datë 10.12.2020, i KLGj-së i është komunikuar ankuesit në datën 6 janar të vitit 2021. Bazuar në pikën 4 të dispozitivit të këtij vendimi, ankuesi në datën 19.01.2021, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin e vendimit nr. 633/2020 të KLGj-së.
7. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 35, datë 26.02.2021, pasi ka marrë në shqyrtim paraprak kërkesën e ankuesit Markelian Kuqo, me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 633, datë 10.12.2020, të KLGj-së “Për caktimin e masës disiplinore ndaj gjyqtarit Markelian Kuqo” dhe rivendosën e të drejtave të kufizuara nga kjo vendimmarrje, vendosi moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare me arsyetimin se: [...] *juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të shkarkimit të gjyqtarëve i ka kaluar juridiksionit disiplinor të KPA-së, gjatë periudhës së funksionimit të tij, sipas mandatit përkatës. Për rrjedhojë, pretendimet që lidhen me procedurën e shkarkimit të kërkesit nuk mund të jenë objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese.*
8. Pasi është njohur me vendimin nr. 35, datë 26.02.2021, të Gjykatës Kushtetuese, magjistrati Markelian Kuqo ka paraqitur ankim ndaj vendimit të KLGj-së nr. 633, datë 10.12.2020, në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), i cili është regjistruar në regjistrin e çështjeve të Juridiksionit Disiplinor me (JD) nr. 2/2021, datë 26.03.2021.
9. Kolegji për Shqyrtimin Paraprak në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, me vendimin nr. 2/1, datë 10.05.2021, ka vendosur kalimin për shqyrtim në seancë plenare publike të çështjes (JD) nr. 2/2021, datë 21.05.2021, që i përket kërkesës së magjistratit Markelian Kuqo (në vijim *ankuesi*) ndaj vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 633, datë 10.12.2020, si dhe thirrjen si person të interesuar të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
10. Kolegji, në kuadër të gjykimit në seancë plenare publike të çështjes nr. 2/2021, datë 26.03.2021, kërkoi paraqitjen e parashtrimeve nga subjektet e interesuara, ILD-së dhe KLGj-së, të cilat paraqitën prapësimet e tyre me shkrim, në përgjigje të kërkesës së mësipërme.
11. Në seancat plenare të zhvilluara në Kolegji, ankuesi realizoi mbrojtjen e tij personalisht, si dhe me prezencën e avokates Marçela Kuqo.

II. Pretendimet e palëve në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

12. Kolegji fillimisht konstaton se ankuesi Markelian Kuqo, në kërkesën drejtuar Kolegjit, ka parashtruar dy grupe pretendimesh. Grupi i parë i pretendimeve ka natyrë kushtetuese dhe procedurale dhe lidhet në disa aspekte me cenimin e së drejtës për proces të rregullt, ndërsa grupi i dytë përfshin pretendime lidhur me vendimmarrjen e KLGj-së.

13. Ankuesi në kërkesën e tij ka parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, sa më poshtë vijon.
14. *Në lidhje me pretendimet e natyrës kushtetuese dhe procedurale që lidhen me procesin e rregullt:*
- 14.1. Në momentin e kryerjes së shkeljes së pretenduar, asnjë dispozitë që parashikonte shkelje disiplinore për magjistratin, nuk ka qenë në fuqi. Në nenin 140, pika 1 e Kushtetutës, përcaktohet se gjyqtari mban përgjegjësi sipas ligjit. Në këtë rast, ligj nuk ka, ndaj Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe vetë Këshilli duhet të kishte proceduar pazgjidhshmërisht me qartësimin apo sqarimin e secilës shkelje disiplinore nën këndvështrimin e vendimit nr. 34/2017 të Gjykatës Kushtetuese.
- 14.2. Ankuesi pretendon se ka pasur paligjshmëri në fillimin e procesit hetimor nga ILD-ja dhe mungesë vlerësimi nga KLGj-ja të argumenteve të paraqitura prej tij për këtë pretendim. Sipas ankuesit, ILD-ja, në momentin e marrjes së vendimit për fillimin e hetimit disiplinor, nuk ka pasur në dispozicion vendimin nr. {***}, datë 14.2.2019, të plotë dhe të arsyetuar, të Gjykatës së Rrethit Korçë (*vendimi objekt procedimi disiplinor*), as dosjen gjyqësore të çështjes së kësaj gjykate dhe as dosjen gjyqësore të shqyrtimit të kësaj çështjeje në Gjykatën e Apelit Korçë.
- 14.3. ILD-ja ka vepruar në kundërshtim me nenin 121 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 96/2016”), pasi nuk ka shqyrtuar fillimisht kriteret e pranueshmërisë së ankesës.
- 14.4. ILD-ja ka vepruar në kundërshtim me shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 100 të ligjit nr. 96/2016, duke cenuar parimin e akuzës, në kuptimin që çdo institucion shtetëror ose zyrtar duhet të veprjë kryesisht dhe të paraqesë një ankesë nëse ka prova të mjaftueshme për të besuar që ka ndodhur një shkelje disiplinore. Sipas ankuesit, hetimi disiplinor është filluar në mënyrë të njëanshme dhe të pajustificuar dhe i ndikuar nga presioni mediatic dhe politik.
- 14.5. ILD-ja nuk rezulton të ketë pasur të dhëna thelbësore mbi fakte që rezultojnë nga burime të besueshme, mbi bazën e të cilave lind dyshimi i arsyeshëm se shkelja mund të jetë kryer, si dhe nuk arriti të provojë para Këshillit të Lartë Gjyqësor ligjshmërinë e procesit në këndvështrim të nenit 124 të ligjit për statusin, duke cenuar në këtë mënyrë parimin e prezumimit të fajësisë dhe atë të barazisë para ligjit, të sanksionuara në shkronjat “ç” dhe “d” të pikës 1 të nenit 100 të ligjit për statusin, si dhe parimin e procesit të rregullt ligjor, të zhvilluar tërësisht në mungesë të parimit të kontradiktoritetit dhe drejtësisë së hapur.
- 14.6. Gjatë zhvillimit të hetimit disiplinor nga ILD-ja, ka pasur mungesë ndërveprimi të ILD-së me ankuesin, i detyrueshëm sipas parashikimeve të neneve 129, 130 dhe 131 të ligjit nr. 96/2016.
- 14.7. Në përmbajtjen e raportit të hetimit të ILD-së, mungon specifikimi ose relatimi i faktit të dyshuar dhe/ose vlefshmëria dhe analiza e tij dhe, për rrjedhojë, ankuesi nuk është në gjendje të çmojë elementet e ligjshmërisë së fillimit të procesit hetimor disiplinor apo nëse është respektuar neni 6 i KEDNj-së.

14.8. Ankuesi parashtron se Komisioni Disiplinor pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor duhet të evidentonte të metat në kërkesën e ILD-së, bazuar në parashikimet e nenit 133 të ligjit për statusin, si dhe në nenet 19 dhe 30 të rregullores “Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, lidhur me dokumentacionin e hetimit, si dhe duhej të kishte konstatuar se ILD-ja, duke iniciuar veprime hetimore shtesë, kishte tejkaluar në hetim objektin e shkeljes së referuar nga ankuesi. Këto të meta, sipas ankuesit, rezultojnë thelbësore në drejtim të mungesës së veprimeve hetimore, mungesës së përfshirjes së magjistratit në hetim, mungesës tërësore të deklaratave të magjistratit mbi faktet objekt hetimi, si dhe mungesës së fakteve si të pranuar apo të papranuar nga ana e magjistratit.

14.9. Këshilli i Lartë Gjyqësor, në respektim të parashikimeve të nenit 139, pika 1, shkronja “ç” e ligjit nr. 96/2016, duhet ta mbyllte procedimin disiplinor pa zhvilluar seancë dëgjimore, pasi raporti i hetimit, i paraqitur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, është depozituar në Këshill i paarsyetuar dhe i paverifikuar nga Këshilli për këtë aspekt të detyrueshëm për verifikim. Ankuesi pretendon se i është hequr mundësia për të paraqitur ankim ndaj vendimeve të Komisionit, si dhe t’i kërkonte mbledhjes plenare të Këshillit mbylljen e procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore, për sa kohë nuk kishte në dispozicion raportin e përfundimit të hetimeve nga ILD-ja, duke mos pasur asnjë mundësi të inicionte kërkesa dhe/ose ankesa që buronin nga trajtimi i përmbajtjes së këtij raporti. Gjithashtu, ankuesi pretendon se i është hequr e drejta për të kërkuar përjashtimin e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, e drejtë e sanksionuar në pikën 7 të nenit 6 të rregullores, që sipas këtij sanksioni mund të ushtrohet vetëm gjatë fazës paraprake dhe jo gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

14.10. KLGj-ja, në seancë dëgjimore, nuk është shprehur për pranueshmërinë e provave të paraqitura nga ankuesi, ndërkohë që për provat e paraqitura para fazës së zhvillimit të seancës dëgjimore, ky Këshill është shprehur në seancën dëgjimore me vendimmarrjet përkatëse për pranimin ose jo të tyre, duke krijuar nja standard të dyfishtë procedural, pasi për çdo provë të kërkuar, Këshilli, me vendimmarrje, duhet të ishte shprehur për pranimin ose jo të tyre, në drejtim të garantimit të një procesi të rregullt ligjor.

14.11. Ankuesi parashtron se nuk i është dhënë mundësia të evidentojë specifikisht shkeljet që i janë atribuar në raportin e hetimit, apo të konceptojë korrektësisht natyrën juridike të përmbajtjes së tyre. Në kundërshtim me parimin e kontradiktoritetit dhe të drejtësisë së hapur, ankuesi shprehet se në seancën dëgjimore në KLGj, nuk i janë dhënë sqarimet e nevojshme nga ILD-ja për ligjin dhe dispozitën përkatëse për çdo shkelje të pretenduar.

15. *Në lidhje me vendimin nr. 633, datë 10.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ankuesi pretendon se:*

15.1. KLGj-ja ka marrë atributet e një gjykate ligji duke cenuar parimin e pavarësisë së gjyqësorit, dhe se shkeljet e paraqitura në vendimin e saj në lidhje me çështjen penale të gjykuar prej ankuesit, kanë të bëjnë me bindjen e brendshme të gjyqtarit.

15.2. Vendimi i KLGj-së paraqitet i paarsyetuar lidhur me detyrimin që ka për të parashtruar, vlerësuar dhe çmuar me argument specifik të kundërtën e argumenteve të parashtruara nga ankuesit. Ankuesi ka paraqitur një tërësi argumentesh kundër veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në drejtim të paligjshmërisë së fillimit të procesit hetimor, procedurës së ndjekur dhe përmbajtjes, argumente këto të cilat nuk gjenden të relatuara, të trajtuara, të vlerësuara dhe çmuara nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

15.3. Vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor paraqitet i paarsyetuar në drejtim të argumentimit të rrëzimit të kërkesave të ankuesit për thirrjen e dëshmitarit dhe të administrimit në cilësinë e provës të praktikës së procedimit të komisionit të mbrojtjes së gjyqtarëve.

15.4. Referuar përmbajtjes së pikës 66.2 të vendimit, se: *Magjistrati ka synuar të injorojë vendimin unifikues të KBLGJ, nr. 4/2003 [...],* KLGj-ja ka marrë atributet e një gjykate ligji, për llojin dhe mënyrën e vlerësimit të saj. KLGj-ja ka dalë jashtë objektit të procesit disiplinor pasi për asnjë rast, nga ana e ILD-së, nuk është relatuar shkelje nga ky këndvështrim trajtues, si kjo që ka trajtuar Këshilli.

15.5. Gjykata e Apelit Korçë nuk ka paraqitur asnjë argument të vetëm në arsyetimin e saj se përse kërkuesi në zgjidhjen e çështjes, duhej të ishte mbështetur në sanksionin e nenit 64, paragrafi 3 i Kodit Penal. Vetë Inspektori i Lartë i Drejtësisë, për asnjë rast, nuk paraqiti para KLGj-së asnjë argument teorik apo të praktikës gjyqësore që të referonte apo konkretizonte bindjen e tij se kërkuesi gjendet në shkelje për moszbatimin e nenit 64, paragrafi 3 i Kodit Penal. Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk ka parashtruar në përmbajtje të vendimit asnjë argument të kundërt në këtë drejtim, përveçse atij se neni 64 ka lidhje me nenin 65 të Kodit Penal, pasi të dyja dispozitat flasin për lirimin me kusht. Lidhur me moszbatimin e parashikimit të nenit 64, paragrafi 3, në zgjidhjen e çështjes, çmuarja nëse kjo përbën ose jo shkelje të ligjit, nuk është në kompetencë të vlerësimit nga ILD-ja apo të vetë Këshillit të Lartë Gjyqësor, për sa kohë që kompetenca për gjykim dhe vlerësim i përket Gjykatës së Lartë.

15.6. Konsiderohet shkelje për gjyqtarin moszbatimi i një vendimi unifikues vetëm në ato raste kur gjykata më e lartë në mënyrë eksplicite ka konstatuar një gjë të tillë dhe një vendimmarrje në kundërshtim me një vendim unifikues. Vendimmarrja e gjykatës në çdo rast i nënshtrohet kontrollit gjyqësor nga gjykata më e lartë dhe konkluzioni mbi atë nëse është shkelur apo nuk është zbatuar një vendim unifikues do të duhet të konstatohet nga gjykata më e lartë, në të kundërt kjo i lë shteg abuzivizmit.

15.7. Lidhur me për zbatimin e ligjit penal favorizues, vendimi unifikues nr. 4/2003 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë ka gjetur trajtim në përmbajtje të arsyetimit të gjykatës, por rezulton se është i paaplikueshëm për rastin specifik të zgjidhur nga gjykata, për lirimin me kusht. Në këtë drejtim, vendimi i mësipërm unifikues nuk paraqitet specifik dhe nuk ka pasur për qëllim të unifikojë gjithë situatat juridike, si dhe është ajo e trajtuar për lirimin me kusht.

15.8. Vendimi unifikues nr. 2/2015 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë është praktikë e detyrueshme gjyqësore vetëm për rastet e lirimit me kusht të parashikuara nga neni 64 i Kodit Penal, por nuk është i vlefshëm për këtë lloj praktike në lidhje me nenin 65 të po këtij kodi.

15.9. Këshilli i Lartë Gjyqësor, ndonëse e mbështet vendimmarrjen e tij në nenin 137 të Kushtetutës, nuk ka bërë të qartë në përmbajtjen e vendimit nëse veprimtaria gjyqësore e ankuesit referon në drejtim të interesit vetjak, keqbesimit apo të dyja këtyre situatave përjashtimore nga imuniteti që gëzon gjyqtari për mendimet e shprehura në marrjen e një vendimi gjyqësor.

16. **Këshilli i Lartë Gjyqësor**, lidhur me shkaqet e ankimit, në mënyrë të përmbledhur ka parashtruar se:

16.1. *Në lidhje me pretendimin e ankuesit Markelian Kuqo se vendimi i KLGj-së paraqitet i paarsyetuar dhe se argumentet e tij nuk gjenden të relatuar, të trajtuara, të vlerësuara dhe çmuara nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor:*

16.1.1. Këshilli çmon se ky pretendim i ankuesit është i pabazuar. Referuar nenit 100 të Kodit të Procedurave Administrative, vendimi i KLGj-së, në cilësinë e aktit administrativ individual, paraqitet i arsyetuar në të gjitha elementet e tij. Në përmbajtje të vendimit, gjejnë pasqyrim faktet e rezultuara nga shqyrtimi i provave dhe u jepet përgjigje pretendimeve e prapësimeve të palëve, si atyre të ngritura nga ILD-ja, ashtu edhe kundërshtimeve të parashtruara nga ankuesi.

16.1.2. Argumentet e parashtruara nga ankuesi, përfshirë edhe pretendimin e tij për mosdënimin pa ligj, gjenden të pasqyruara hollësisht në faqet 16-22 të vendimit nr. 633, datë 10.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për caktimin e masës disiplinore ndaj magjistratit Markelian Kuqo”.

16.2. *Në lidhje me pretendimin e ankuesit, sipas të cilit në vendimin e KLGj-së, nuk ekziston i pasqyruar/dhënë asnjë argument se përse kërkesat e tij janë rrëzuar:*

16.2.1. Nga përmbajtja e vendimit të KLGj-së objekt ankimi, rezulton se kërkesat e ankuesit janë rrëzuar me arsyetimin përkatës brenda diskrecionit që organi administrativ ka. Në vendimin e Këshillit, është dhënë i plotë shkaku i rrëzimit të secilës kërkesë të ankuesit, rrëzime këto të shprehura me vendim në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 115 të ligjit nr. 96/2016. Këshilli ka vepruar në përputhje dhe në zbatim të plotë të ligjit të zbatueshëm, Kodit të Procedurave Administrative, si dhe ligjit nr. 96/2016.

16.3. *Në lidhje me pretendimin e ankuesit, sipas të cilit Këshilli i Lartë Gjyqësor, duke u shprehur se magjistrati ka synuar të injorojë vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 4/2003, ka marrë atributet e një gjykate ligji, për llojin dhe mënyrën e vlerësimit të tij:*

16.3.1. KLGj-ja sqaron se pretendimi për shkelje të vendimit unifikues nr. 4/2003 të Gjykatës së Lartë, është referuar fillimisht nga Ministria e Drejtësisë, ndërsa është specifikuar edhe në vendimin e ILD-së për fillimin e hetimit disiplinor, si një ndër shkaqet e fillimit të këtij hetimi ndaj

ankuesit. Në vijim, në përfundim të hetimit disiplinor, në përmbajtje të raportit të hetimit disiplinor të ILD-së, si dhe parashtrimeve të ILD-së në seancë, në të kundërt sa pretendon ankuesi, rezulton se ILD-ja ka parashtruar si një tërësi nga shkeljet e kryera nga ky i fundit, edhe mosrespektimin e vendimit unifikues nr. 4, datë 27.03.2003, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

16.3.2. Gjykata e Apelit Korçë, në vendimin e vet, lidhur me këtë moment, ka theksuar se arsyetimi është kontradiktor në referimin e ligjit të zbatueshëm, atë të kohës së kryerjes së veprave penale, mbasi kur analizon kriteret ndaluese për lirimin me kusht që parashikon neni 65 i Kodit Penal, për dy kushte të parashikuara nga e njëjta dispozitë, njëherë zbaton ligjin penal të kohës kur është kryer vepra penale dhe për kushtin tjetër zbatohet ligji penal i kohës kur paraqitet dhe shqyrtohet kërkesa për librim me kusht (transferimi i të dënuarit).

16.4. *Në lidhje me pretendimin sipas të cilit argumenti që ka prezantuar Këshilli, nuk është i njëjtë me argumentin që Gjykata e Apelit ka përdorur për të cenuar vendimin objekt procedimi disiplinor ndaj tij, KLGj-ja prapëson se në përmbajtje të vendimit të saj, rendit si shkelje të ligjit në veprimtarinë e ankuesit në vendimin nr. {***}, datë 14.02.2019, vetëm shkeljet e evidentuara nga Gjykata e Apelit Korçë në vendimin nr. {***}, datë 26.06.2019.*

16.5. *Në lidhje me pretendimet se i është hequr e drejta për të kërkuar përjashtimin e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, i është hequr mundësia për të paraqitur ankim ndaj vendimeve të Komisionit, si dhe t'i kërkonte mbledhjes plenare të Këshillit mbylljen e procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore:*

16.5.1. Këshilli, me vendimin nr. {***}, datë 26.08.2020, ka hedhur shortin dhe ka caktuar relatorin e çështjes. Ky vendim i Këshillit u është komunikuar palëve, ILD-së dhe ankuesit, më datë 27.08.2020, në respektim të afatit 5-ditor të parashikuar nga neni 141 i ligjit nr. 96/2016.

16.5.2. Me vendimin nr. {***}, datë 17.09.2020, mbi propozimin e relatorit të çështjes, Këshilli ka vendosur kalimin e çështjes në seancë dëgjimore, duke njoftuar rregullisht palët në zbatim të parashikimeve të nenit 138 të ligjit nr. 96/2016. Bashkë me njoftimin për caktimin e seancës dëgjimore, ankuesit i janë njoftuar dhe të drejtat e tij gjatë procedimit disiplinor.

16.5.3. Në të kundërt nga sa pretendohet, asnjë e drejtë nuk i është mohuar ankuesit as nga Komisioni Disiplinor dhe as nga Këshilli, duke pasur dijeni të plotë për relatorin e çështjes për të cilin nuk ka pasur asnjë kërkesë përjashtimi, ka pasur dijeni për datën e seancës dëgjimore dhe i është garantuar e drejta për të paraqitur parashtrësia me shkrim, ku bashkë me to mund të kërkonte përjashtim të relatorit apo ndonjë anëtar të Këshillit. Ankuesi nuk ka paraqitur asnjë pretendim të tillë para Këshillit dhe, për rrjedhojë, Këshilli nuk ka asnjë vendimmarrje për shkak mungese të kërkesave me këtë natyrë, dhe ankuesi nuk mund të ngrejë një pretendim të tillë para Kolegjit.

16.5.4. I pabazuar mbetet pretendimi i kërkuarit për të kërkuar mbylljen e procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore. Mbyllja e procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore është në kompetencë të Këshillit dhe ndodh vetëm në rastet e parashikuara nga neni 139 i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin".

Këshilli ka arsyetuar hollësisht mungesën e rasteve të parashikuara në këtë dispozitë.

17. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur, sa më poshtë.

17.1. Lidhur me pretendimet për cenimin e parimit kushtetues të pavarësisë së gjyqtarëve:

17.1.1. Në rastin e hetimit disiplinor të filluar dhe të përfunduar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë ndaj ankuesit, është respektuar në çdo element parimi kushtetues i pavarësisë së gjyqtarëve. Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk ka marrë atributet e një gjykate për gjykimin në themel të bazueshmërisë në ligjin material dhe procedural të vendimit nr. {***}, datë 14.02.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, dhënë nga ankuesi. Mosrespektimi i rëndë dhe shkelja e dispozitave të ligjit procedural dhe material nga ankuesi nuk është konstatuar as nga ILD-ja, as nga KLGj-ja, por nga një gjykatë më e lartë, përkatësisht Gjykata e Apelit Korçë, në kuadër të kontrollit gjyqësor që është realizuar nga kjo gjykatë.

17.1.2. Në lidhje me pretendimin e cenimit të parimit të "mosdënimit pa ligj":

17.1.3. Në rastin e hetimit dhe procedimit disiplinor të ankuesit, subjektet e interesuara, ILD-ja dhe KLGj-ja, kanë zbatuar drejtpërdrejt normën më të lartë juridike, pikërisht parashikimin e bërë nga neni 140, pika 2, shkronja "a" e Kushtetutës, normë e cila sanksionon shkarkimin nga detyra të gjyqtarit në rastin e kryerjes së shkeljeve të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e tij gjatë ushtrimit të detyrës.

17.1.4. Fakti që në kohën e dhënies së vendimit nga gjyqtari Markelian Kuqo, datë 14.02.2019, shkeljet disiplinore të parashikuara në nenet 101, 102, 103 dhe 104, të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ishin shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 34/2017, nuk mund të nënkuptojë kurrësi që magjistrati të mos përgjigjet disiplinarisht në rast se nga hetimi dhe procedimi disiplinor rezulton e provuar, se janë plotësuar kriteret e parashikuara nga neni 140, pika 2, shkronja "a" e Kushtetutës.

17.1.5. Në lidhje me pretendimet me natyrë procedurale:

17.1.6. Në lidhje me pretendimin e ankuesit se ILD-ja në momentin e fillimit të hetimit disiplinor, duke mos pasur në dispozicion arsyetimin e gjykatës së faktit, nuk ka qenë i njohur me natyrën ligjore të zgjidhjes së çështjes, ILD-ja sqaron se, në këndvështrim të nenit 123 të ligjit nr. 96/2016, vendimmarrja për fillimin e hetimit mbështetet në dyshimin e arsyeshëm se shkelja mund të ketë ndodhur. Hetimi disiplinor mund të fillojë edhe pa një procedurë paraprake të verifikimit, kur ka informacion dhe të dhëna të mjaftueshme, që rezultojnë nga ankesa dhe dokumentacioni që e shoqëron atë, të cilat krijojnë dyshimin e arsyeshëm se shkelja disiplinore mund të ketë ndodhur. Në rastin e ankuesit, ankesa është paraqitur nga ana e ministrit të Drejtësisë, dhe argumentet e dhëna në ankesën e ministrit të Drejtësisë, së bashku me vendimin nr. {***}, datë 26.06.2019, të Gjykatës së Apelit Korçë, të administruar në kuadër të inspektimit tematik të gjykatave dhe zyrave të prokurorive pranë tyre mbi trajtimin e kërkesave me objekt "lirim para kohe me kusht", kanë

krijuar elemente të mjaftueshme juridike dhe rrethana të mjaftueshme faktike, të cilat, të shqyrtuara dhe vlerësuara në tërësi, krijuan në mënyrë të logjikshme dhe të paanshme standardin e dyshimit të arsyeshëm, se shkelja disiplinore mund të jetë kryer dhe se kjo shkelje është kryer nga ankuesi ndaj të cilit u fillua hetimi disiplinor.

17.1.7. Pretendimi për mosshqyrtimin e kritereve të pranueshmërisë së ankesës nga ana e ILD-së, përpara marrjes së vendimit për fillimin e hetimit disiplinor ndaj ankuesit, është një pretendim i pabazuar dhe një pasqyrim jo i saktë i vendimmarrjes së ILD-së. Bazuar në parashikimet e neneve 120 dhe 121 të ligjit, ILD-ja, përpara marrjes së një vendimi për verifikimin apo fillimin e hetimit disiplinor, shqyrton fillimisht përmbushjen e kritereve të pranueshmërisë së ankesës. Analiza e përmbushjes së këtyre kritereve është e materializuar në vendimin nr. {***}prot., datë 02.04.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit Markelian Kuqo, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë”.

17.1.8. ILD-ja prapëson se pretendimi për cenim të parimit të akuzës, për shkak se hetimi disiplinor është filluar në mënyrë të njëanshme dhe të pajustificuar dhe i ndikuar nga presioni mediatik dhe politik, është tërësisht i paargumentuar. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është i pajisur nga Kushtetuta dhe ligji me tagrat e nevojshëm për kryerjen e një procesi të plotë, të gjithanshëm hetimi, në funksion të respektimit të parimit të procesit të rregullt ligjor. Në rastin konkret, pavarësisht formulimit të bërë në ankesën e ministrit të Drejtësisë, ILD-ja, në cilësinë e një organi kushtetues të pavarur, ka zhvilluar një hetim tërësisht të pavarur nga përfundimet e ministrit të Drejtësisë. Të dhënat e referuara në ankesën e ministrit të Drejtësisë, kanë shërbyer vetëm si bazë për verifikimin e mëtejshëm të fakteve apo për fillimin e hetimit disiplinor në rastin e krijimit të standardit të dyshimit të arsyeshëm se shkelja disiplinore është kryer. Ndërkohë që i gjithë procesi i hetimit disiplinor është kryer në pavarësi dhe paanësi të plotë nga ILD-ja, duke respektuar plotësisht parimet dhe procedurat e parashikuara nga ligji.

17.1.9. *Në lidhje me thelbin e çështjes:*

17.1.10. Në analizë të elementeve të referuara në vendimin nr. 75/2002 të Gjykatës Kushtetuese, në raport me sjelljen e ankuesit, rezulton se:

- Gjatë dhënies së vendimit {***}, datë 14.02.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, në kundërshtim me parashikimet e nenit 64, paragrafi 3 i Kodit Penal, pavarësisht provave të administruara, si dhe fakteve të provuara në këtë proces gjyqësor, ankuesi ka bërë një parashtrim të shtrembëruar të fakteve dhe rrethanave në mënyrë të dukshme në aktet e nxjerra.

- Pavarësisht provave të administruara, si dhe fakteve të provuara, në këtë proces gjyqësor nuk është mbajtur në konsideratë kriteri ndalues me natyrë objektive, sipas të cilit nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje.

- Në kundërshtim me parashikimet e neneve 3 dhe 65, paragrafi 3 i Kodit Penal, si dhe me vendimin unifikues nr. 4, datë 27.03.2003, të Kolegjeve të Bashkuara, nga ana e ankuesit, subjekt hetimi disiplinor, nuk është mbajtur në konsideratë plotësimi i kërkesës ligjore me natyrë objektive, si koha e nevojshme e kaluar në vuajtje të dënimit me burgim, prej 35 vitesh, parashikuar

nga neni 65, paragrafi 3 i Kodit Penal, si dhe janë zbatuar gabim dispozitat të cilat lidhen me aplikimin e ligjit penal në kohë, parashikuar nga neni 3 i Kodit Penal.

-Në kundërshtim me parashikimet e neneve 64 dhe 65 të Kodit Penal, si dhe me vendimin unifikues nr. 2, datë 25.05.2015, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nuk janë zbatuar kërkesat mbi plotësimin e kriterëve ligjore me natyrë subjektive, siç janë “arsyet e veçanta” apo “rastet e jashtëzakonshme”.

- Nuk janë zbatuar dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, lidhur me parashikimet e neneve 152, 380 dhe 383, pika 1, shkronja “ç” e këtij kodi. Arsytimi i bërë nga ana e ankuesit, nuk është në përputhje me provat e administruara në gjykim dhe në përputhje me faktet dhe rrethanat që janë provuar gjatë procesit gjyqësor. Faktet dhe rrethanat janë parashtruar dukshëm në mënyrë të shtrembëruar dhe vetëm për t’iu përshtatur plotësimin të kërkesave formale (*me natyrë objektive*), si dhe atyre me natyrë subjektive të neneve 64 dhe 65 të Kodit Penal.

-Nuk janë mbajtur në konsideratë parashikimet e neneve 3, 64, 65 të Kodit Penal, nenit 152, 380, 383/ç të Kodit të Procedurës Penale, neneve 9, 10 dhe 11 të ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar, si dhe parashikimet e vendimeve unifikuese nr. 4/2003 dhe nr. 2/2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

- Për sa i takon momentit subjektiv, rezulton se nga ankuesi janë ndërmarrë veprime/mosveprime, të cilat kanë të bëjnë me mosrespektim të rëndë dhe të vazhduar të legjislacionit material dhe procedural penal. Këto veprime/mosveprime të tij janë kryer në mënyrë të drejtpërdrejtë, të vazhduar, të vullnetshme dhe të pajustificuar, brenda të njëjtit proces gjyqësor, ku përvoja e gjatë profesionale në detyrë e ankuesit e lejon të interpretojë dhe zbatojë drejt këto dispozita. Për më tepër, ankuesi nuk ka respektuar as praktikën e ndjekur nga vetë ai, gjatë trajtimit të kërkesave me objekt “Lirim me kusht”.

- Në lidhje me elementin e pasojave që i shkaktohen shoqërisë, rezulton se shkeljet disiplinore të kryera nga ankuesi kanë sjellë pasoja jo vetëm në cenimin e imazhit të gjyqtarit dhe humbjen e besimit ndaj tij, por kanë cenuar edhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

17.1.11. Në përfundim, ILD-ja konstaton se në këndvështrim të kësaj analize, rezulton se përmbushen të gjithë elementet e vlerësuara në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, të cilat tregojnë se ankuesi ka kryer shkelje të cilat diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës, si dhe klasifikohen si shkelje shumë e rëndë disiplinore në referim të nenit 140/b, pika 2, shkronja “a” e Kushtetutës.

III. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Për legjitimimin e ankuesit

18. Juridiksioni dhe kompetenca e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në kuadër të Juridiksionit Disiplinor, janë parashikuar në nenin 179, pika 7 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas së cilës: *Gjatë mandatit të tyre nëntëvjeçar, gjyqtarët e Kolegjit të Apelit, sipas nenit 179/b, kanë juridiksion disiplinor ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, anëtarëve të*

Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Kolegji i Apelit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore, përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.

19. Në vendimin nr. 2/2018 (JD), datë 21.06.2018, Kolegji ka vlerësuar se shqyrtimi i të gjitha ankesave apo kërkesave të paraqitura e të regjistruara në Kolegjin e Posaçëm të Apelit në kuadër të juridiksionit të tij disiplinor, do të bëhet sipas dispozitave të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” (në vijim “ligji nr. 8577/2000”), për sa i përket natyrës e procedurës së gjykimit. Kolegji, në këtë mënyrë, i ka konsideruar këto kërkesa si një gjykim kushtetues, të ndryshëm për nga natyra me gjykimin që Kolegji i Posaçëm i Apelit bën në rastet kur ai gjykon sipas juridiksionit të tij rivlerësues.
20. Çështja e legjitimitetit është vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i" dhe pika 2 e Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.
21. Ankimi kushtetues individual duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.
22. Në çështjen objekt shqyrtimi, lidhur me legjitimitetin e ankuesit, Kolegji vlerëson se ankuesi Markelian Kuqo legjitimohet *ratione personae*, pasi vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor të cilin ai e ka ankimuar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, është marrë në kuadrin e një procedimi disiplinor ndaj tij dhe ankuesi ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.
23. Në lidhje me *shterimin e mjeteve juridike*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f” e Kushtetutës, konstatohet se, bazuar në nenin 179, pika 7 e Kushtetutës dhe nenin 100, pika 1 e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor për masat disiplinore ndaj gjyqtarëve, ankimohen në Gjykatën Kushtetuese (Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda mandatit nëntëvjeçar). Pra, ankuesi nuk ka mjet tjetër ligjor ankimi, përveç kërkesës drejtuar Kolegjit.
24. Lidhur me verifikimin e kushteve të pikës 2, shkronja “ç” e nenit 31/a të ligjit nr. 8577/2000, që kanë të bëjnë me afatin ligjor brenda të cilit duhet paraqitur kërkesa, nga të dhënat e akteve rezulton se vendimi i arsyetuar i KLGj-së i është komunikuar ankuesit më datë 06.01.2021.

Në vijim, duke ndjekur literalisht udhëzimin e KLGj-së në pjesën urdhëruese të vendimit për ankimin e tij, ankuesi, më datë 19.01.2021, i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. 633, datë 10.12.2020, të KLGj-së.

25. Për sa më sipër, në drejtim të afatit të paraqitjes së kërkesës në zbatim të përcaktimit të pikës 2 të nenit 31, shkronja “a” e ligjit nr. 8577/2000, i cili parashikon se si datë e paraqitjes së kërkesës konsiderohet data e paraqitjes së saj për herë të parë në gjykatë, si në rastin nëse përllogaritja e afatit nis në momentin e paraqitjes së ankimit në Gjykatën Kushtetuese më datë 19.01.2021, ashtu edhe në rastin kur përllogaritja e afatit nis në datën e regjistrimit të çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, përkatësisht më datë 26.03.2021, rezulton se në të dyja këto raste ankimi plotëson kushtin e paraqitjes se tij brenda afatit 4-mujor nga konstatimi i cenimit, të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 8577/2000.
26. Për sa i takon legjitimitetit *ratione materiae*, Kolegji çmon se pretendimet e ankuesit ndaj vendimit nr. 633, datë 10.12.2020, të KLGj-së, janë pretendime që *prima facie* hyjnë në juridiksionin disiplinor të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe do të shqyrtohen në vijim.
27. *Mbi kërkesat procedurale të ankuesit gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj:*

27.1. Në seancën e datës 13.12.2021, Kolegji bazuar në nenet 1, paragrafi 2, dhe 42 të ligjit nr. 8577/2000, vendosi të pranohet kërkesën e ankuesit Markelian Kuqo dhe t’i drejtohet Këshillit të Lartë Gjyqësor për të kërkuar sjelljen e fashikujve me të gjitha aktet e administruara dhe të krijuara në funksion të procedimit disiplinor, në bazë të të cilit është marrë vendimi nr. 633, datë 10.12.2020. Kolegji e vlerësoi të drejtë këtë kërkesë të ankuesit duke pasur në konsideratë natyrën e këtij gjykimi, i cili përfshin elemente të procesit kushtetues, por edhe elemente të një gjykimi administrativ, për sa kohë që juridiksioni i gjykatës në këtë rast, është i posaçëm dhe ndërthur kërkime me natyrë kushtetuese, por edhe kërkime/pretendime që lidhen me elemente të situatës faktike e vlerësim të rrethanave specifike në të cilat është zbatuar ligji. Në këto kushte, Kolegji çmoi se për marrjen e një vendimi që kontrollon aktin individual të një organi kushtetues administrativ, duhet të shqyrtojë të gjitha faktet që kanë rezultuar nga provat e marra në shqyrtim prej tij e mbi të cilat, është mbështetur vendimmarrja.

27.2. KLGj-ja ka përcjellë në Kolegj, me shkresën nr. {***} prot., datë 10.01.2022, fashikujt e plotë me të gjitha aktet e administruara dhe të krijuara në funksion të këtij procedimi disiplinor. Ankuesi u njoftua dhe ushtroi të drejtën për njohjen dhe marrjen e kopjeve për disa prej akteve të KLGj-së, sipas kërkesës së tij, të përcjella në Kolegj.

27.3. Ankuesi ka paraqitur në seancën e datës 15.02.2022, kërkesën paraprake mbi mungesën e kompetencës lëndore funksionale për gjykimin e ankimit nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, me argumentin se Kolegji ka juridiksion disiplinor për çdo masë tjetër disiplinore të dhënë ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Shqipërisë, përveç shkarkimit nga detyra, që është kompetencë e drejtpërdrejtë e Gjykatës Kushtetuese. Kolegji, me vendimin e ndërmjetëm të datës

15.02.2022, vendosi rrëzimin e kësaj kërkesë, bazuar në nenin 179, pika 7 e Kushtetutës; nenin 5, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"; nenin 71, pika 3 e ligjit 8577, datë 10.02.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; si edhe në referim të vendimit nr. 35, datë 26.02.2021, të Kolegjit të Shqyrtimit Paraprak të Gjykatës Kushtetuese. Në përgjigje të pretendimit të ankuesit për moszbatimin e nenit 140 të Kushtetutës prej Kolegjit, për shkak të kufizimeve të parashikuara në nenin A të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji solli në vëmendje se përfshirja e nenit 140 të Kushtetutës, në nenin A të Aneksit të saj, lidhet me kufizimin e kriterëve të parashikuara nga ky nen përgjatë procesit të rivlerësimit dhe vendosjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra sipas këtij procesi, në zbatim të ligjit nr. 84/2016. Në vlerësimin e Kolegjit, kjo dispozitë është e kufizuar në zbatimin e saj prej Kolegjit si organ rivlerësimi në rastet kur gjykon çështjet e juridiksionit të rivlerësimit. Ky parashikim nuk përcakton përjashtimin e Kolegjit nga juridiksioni disiplinor, i cili është një juridiksion i posaçëm tranzitor i Kolegjit, i parashikuar nga neni 179, pika 7 e Kushtetutës sipas së cilës: *Kolegji i Apelit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore, përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë*, juridiksion i cili legjitimon plotësisht Kolegjin të zbatojë nenin 140 të Kushtetutës në të gjitha elementet e tij, njësoj si Gjykata Kushtetuese do të veprojë sapo të rimarrë këtë juridiksion si pjesë të veprimtarisë së saj.

27.4. Gjatë zhvillimit të seancës gjyqësore të datës 15.02.2022, ankuesi paraqiti dhe një kërkesë paraprake për plotësimin e parashtrësive të KLGj-së, pasi kishte konstatuar nga pikëpamja formale, se dokumenti paraqet vetë vullnetin e nënshkruesit të asaj parashtrëse, ndërkohë që nuk ka asnjë referencë ligjore nëse gjithçka që është në përmbajtje të saj është qëndrim i organit kolegjal, KLGj-së. Kolegji vendosi që kërkesat e paraqitura në mënyrë verbale nga ankuesi, nuk mund të trajtohen në kuadër të ankesave paraprake, por gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes. Po në këtë seancë, ankuesi u drejtoi një sërë pyetjesh subjekteve të interesuara, pjesëmarrëse në këtë proces gjyqësor, të cilat u paraqitën edhe me shkrim dhe u depozituan në Kolegji. Në përgjigje të këtyre pyetjeve, përfaqësuesi i KLGj-së dhe përfaqësuesit e ILD-së depozituan përgjigjet dhe sqarimet ndaj pyetjeve të ankuesit.

27.5. Në seancën e datës 11.03.2022, Kolegji, i konsultuar në dhomë këshillimi, referuar rrethanave të çështjes objekt shqyrtimi, mungesës së kontrollit përfundimtar dhe të plotë të sistemit gjyqësor mbi vendimmarrjen e vetme të ankuesit që është konsideruar se ka përbërë shkelje disiplinore, interpretimit dhe analizës së ligjit penal të kryer në çështjen konkrete, në kushtet e mungesës së një praktike gjyqësore të njësuar apo të unifikuar nga Gjykata e Lartë, duke vlerësuar se marrja e një vendimi për procedimin disiplinor të ankuesit do të ishte e cënueshme pa pasur një qëndrim përfundimtar të Gjykatës së Lartë mbi këtë çështje, si gjykata kompetente për çështjet e ligjit, bazuar në nenin 1, paragrafi i dytë i ligjit nr. 8577/2000, dhe në nenin 297, shkronja "a" e Kodit të Procedurës Civile, vendosi të pezullojë gjykimin e çështjes së juridiksionit disiplinor me nr. 2/2021, që i përket ankuesit Markelian Kuqo, deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes penale

lidhur me rekursin e shtetasit G. Gj., të depozituar në Gjykatën e Lartë me nr. {***}, datë regjistrimi 7.10.2019. Ky vendim iu përcoll për dijeni Gjykatës së Lartë.

27.6. Pas gjykimit të çështjes, Gjykata e Lartë i ka përcjellë Kolegjit të Posaçëm të Apelit vendimin e Kolegjit Penal nr. {***}, datë 14.06.2022, me kërkues G. Gj., me objekt “Lirim me kusht”. Me këtë vendim, Gjykata e Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 26.06.2019, të Gjykatës së Apelit Korçë.

27.7. Pasi vendimi i mësipërm iu njoftua palëve në gjykim, Kolegji caktoi seancën gjyqësore të radhës për të vijuar me verifikimin e ekzistencës ose mungesës së shkakut të pezullimit dhe dëgjoi qëndrimet e palëve rreth këtij momenti procedural. Ankuesi kundërshtoi vendimin e pezullimit nr. {***} prot., datë 11.03.2022, të Kolegjit, me argumentin se ky vendim është mbështetur në një dispozitë të Kodit të Procedurës Civile, nenin 297, shkronja “a”, ndërkohë që karakteri procedural i gjykimit të juridiksionit disiplinor është i natyrës administrative dhe rregullohet vetëm nga Kodi i Procedurave Administrative. Sipas ankuesit, Kolegji nuk ka mbajtur në konsideratë dhe nuk ka zbatuar kërkesat e nenit 1, paragrafi i dytë i ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, duke mos mbajtur parasysh natyrën ligjore të çështjes, e cila nuk mundëson të procedohej kryesisht me pezullimin e gjykimit dhe për më tepër, duke devijuar karakterin e ankimit.

27.8. Kolegji konstatoi se pretendimet e paraqitura nga ankuesi në këtë seancë, janë kundërshtime ndaj vendimit të pezullimit, duke u konsideruar si një ankim ndaj tij. Vendimi i pezullimit është marrë kryesisht nga gjykata, *ex-officio*, pa një kërkesë të palëve pjesëmarrëse në gjykim dhe, si rrjedhojë, pa qenë nevoja për një debat gjyqësor në seancën e datës 11.03.2022. Vendimi për pezullim u mor në bisedime në dhomë këshillimi, në zbatim të dispozitave procedurale civile, të cilat rregullojnë veprimtarinë procedurale të kësaj gjykate dhe nuk është bazuar në kuadrin ligjor që rregullon veprimtarinë e organeve administrative kolegjiale. Kolegji vlerësoi se ky vendim pezullimi është i paankimueshëm. Për këtë qëndrim, Kolegji mbajti në konsideratë pozitën, juridiksionin, kompetencën që i ka njohur Kushtetuta dhe legjislacioni në fuqi Kolegjit, në kuadrin të juridiksionit disiplinor, duke e konsideruar atë si gjykatën e vetme të procesit. Duke qenë se vendimi i pezullimit, i shpallur në seancën e datës 11.03.2022, përmban arsyet e dhënies së tij dhe i është komunikuar ankuesit, si dhe subjekteve të interesuara në këtë gjykim, Kolegji konsideroi si të pabazuara kërkesat e paraqitura nga ankuesi Markelian Kuqo nëpërmjet parashtrimeve të depozituara dhe, si të tilla, ato nuk u pranuan.

27.9. Ankuesi paraqiti si kërkesë dhe mosmarrjen si provë nga Kolegji të vendimit të Gjykatës së Lartë, me argumentin se ky vendim, ligjërisht dhe proceduralisht, nuk mund të përdoret *a priori* në zgjidhje të rastit objekt procedimi disiplinor. Zgjidhja materiale e çështjes nga Gjykata e Lartë, sipas ankuesit, nuk e bën të ligjshme dhe të vlefshme procedurën dhe përfundimin e saj para Këshillit të Lartë Gjyqësor me caktimin e masës disiplinore.

27.10. Për sa i përket kësaj kërkesë të ankuesit, Kolegji mbajti qëndrimin se pesha dhe rëndësia e

vendimit të Gjykatës së Lartë për rekursin që ka bërë i gjykuari G. Gj., do të analizohet dhe do të shqyrtohet gjatë diskutimit dhe vendimmarrjes së Kolegjit për zgjidhjen e çështjes.

27.11. Për sa më sipër, Kolegji, bazuar në nenin 298 të Kodit të Procedurës Civile, pasi verifikoi se ka rënë shkak i pezullimit me marrjen e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, vendosi të revokojë vendimin e ndërmjetëm të datës 11.03.2022 dhe të vijojë gjykimin në seancë gjyqësore publike të çështjes (JD) nr. 2/2021, datë 21.05.2021, në fazën procedurale ku ai ishte ndërprerë. Gjithashtu, Kolegji, bazuar në nenin 42, pika 2 e ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, pranoi kërkesën e subjekteve të interesuara, KLGj dhe ILD, dhe vendosi të administrojë si provë vendimin e Gjykatës së Lartë nr. {***}, datë 14.06.2022.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, palët ndërgjyqëse paraqitën me shkrim konkluzionet e tyre përfundimtare.

B. Vlerësimi i Kolegjit lidhur me pretendimet e ankuesit

28. Kolegji mori në shqyrtim pretendimet e ankuesit kundrejt vendimit nr. 633, datë 10.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të natyrës kushtetuese e procedurale e që lidhen me procesin e rregullt, si edhe ato që i adresohen thelbit të zgjidhjes së çështjes, duke i analizuar ato edhe në këndvështrim të propësimëve që kanë bërë prezent në gjykim subjektet e interesuara, KLGj-ja e ILD-ja.

B.1. Lidhur me shkaqet e ankimit të natyrës kushtetuese, si dhe për aspekte procedurale në kuadër të procesit të rregullt ligjor gjatë hetimit dhe procedimit disiplinor nga ILD-ja dhe KLGj-ja

29. Ankuesi pretendon se në momentin e kryerjes së shkeljes disiplinore të përcaktuar prej organeve disiplinore, nuk ka qenë në fuqi asnjë dispozitë që parashikonte shkelje disiplinore për magjistratin, rrethanë dhe trajtim për të cilën Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka heshtur dhe e ka anashkaluar në konkluzionet përfundimtare në KLGj. Edhe vetë KLGj-ja, sipas ankuesit, ka anashkaluar plotësisht trajtimin e kësaj rrethane thelbësore, duke e bërë vendimin të paarsyetuar dhe në cenim të procesit të rregullt ligjor. Në nenin 140, pika 1 e Kushtetutës, përcaktohet se gjyqtari mban përgjegjësi sipas ligjit. Në këtë rast, ligj nuk ka, ndaj Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe vetë Këshilli duhet të kishte proceduar pazgjidhshmërisht me qartësimin apo sqarimin e secilës shkelje disiplinore nën këndvështrimin e vendimit nr. 34/2017 të Gjykatës Kushtetuese.

29.1. Në lidhje me këtë pretendim, Kolegji konstaton se vendimi nr. 633, datë 10.12.2020, i KLGj-së, në tërësinë e tij, është bazuar në nenin 140, pika 2, shkronja “a” e Kushtetutës. Kolegji vlerëson se përmbajtja e këtij vendimi dhe argumentimi i dhënë nga KLGj-ja janë në frymën e vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 3, datë 20.02.2006, për rastet e zbatimit drejtpërdrejt të dispozitës kushtetuese në rastet e shkarkimit të gjyqtarëve. Në këtë vendim, Gjykata Kushtetuese është shprehur se: [...] *Shkarkimi nga detyra i gjyqtarit, e drejta e ankimit ndaj këtij vendimi, si dhe*

organi që duhet ta marrë atë në shqyrtim rregullohen drejtpërdrejt nga Kushtetuta. Kjo përbën një garanci më shumë për gjyqtarët, për shkak të funksionit që ata kryejnë dhe misionit që u ka ngarkuar shteti dhe shoqëria [...]. Shfuqizimi i kësaj dispozite nuk krijon boshllëk ligjor, sepse mund të zbatohet direkt rregullimi i nenit 147/6 të Kushtetutës [...]. Nisur nga këto arsye, Gjykata Kushtetuese konstaton se Kushtetuta nuk ka pasur për qëllim që të autorizojë ligjvënësin të parashikojë rastet e shkarkimit, pasi këtë ajo e ka bërë nëpërmjet nenit 147/6 të saj, sipas të cilit gjyqtari mund të shkarkohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë për kryerjen e një krimi, për paaftësi mendore a fizike, për akte a sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit ose për pamjaftueshmëri profesionale. Ndërsa, sa i përket dhënies së masave të tjera disiplinore, neni 147/4 i Kushtetutës ia ka deleguar kompetencat ligjvënësit të zakonshëm, për të parashikuar rastet dhe kriteret e zbatimit konkret të tyre [...].

29.2. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur Kolegji, duke iu referuar përmbajtjes së nenit 140, pika 2 e Kushtetutës, në vendimin tij nr. 2, datë 31.05.2022, në të cilin është shprehur se: *Kolegji çmon se kjo dispozitë në mënyrën si është formuluar, në rastin e kryerjes së shkeljeve të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit, nuk i ka dhënë mundësi delegimi ligjit për të përcaktuar masën disiplinore, por është shprehur qartë se këto raste përbëjnë shkaqe kushtetuese që shërbejnë për shkarkimin nga detyra të gjyqtarit. [...] Në këtë mënyrë, kushtetutëbërësi, në përcaktimin e shkaqeve me vërtetimin e të cilave zbatohet direkt masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, e ka konsideruar nenin 140 si një dispozitë drejtpërdrejt të zbatueshme, në frymë dhe në harmoni me parashikimin e nenit 4, pika 3 e Kushtetutës.*

29.3. Ndërsa në vendimin nr. 1, datë 30.05.2022, Kolegji është shprehur se: *Kolegji çmon se mungesa e parashikimeve ligjore nuk mund të sjellë mungesën e ushtrimit të kontrollit të veprimtarisë së magjistratëve nga organi i parashikuar me ligj dhe nga ana tjetër, nuk mund të përdoret nga magjistrati si shkak për të mos përmbushur funksionin e tij në mënyrë të rregullt apo për të kryer shkelje profesionale të natyrës që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës.*

29.4. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se pretendimi i ankuesit për mungesë të ligjit, është i pabazuar dhe se KLGj-ja ka qenë e autorizuar nga neni 4, pika 3 e Kushtetutës të zbatojë drejtpërdrejt nenin 140 të saj.

- 30.** Ankuesi pretendon se ka pasur paligjshmëri në fillimin e procesit hetimor, pasi ILD-ja, në momentin e marrjes së vendimit për fillimin e hetimit disiplinor, nuk ka pasur në dispozicion vendimin nr. {***}, datë 14.2.2019, të plotë dhe të arsyetuar, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, as dosjen gjyqësore të çështjes në këtë gjykatë dhe as dosjen gjyqësore të shqyrtimit të kësaj çështjeje në Gjykatën e Apelit Korçë, por vetëm ankesën e ministres së Drejtësisë nr. {***} prot., datë 20.2.2019 dhe aktet bashkëlidhur saj (vendimin e përmbledhur të gjykatës së faktit, vendimin nr. 14, datë 10.3.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendimin nr. {***}, datë 2.3.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe vendimin unifikues nr. 4/2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë).

30.1. Ankuesi parashtron se kjo mënyrë e menaxhimit të procesit nga ILD-ja, vjen në kundërshtim me pikën 1, shkronja “b” e nenit 100 të ligjit nr. 96/2016, pasi është cenuar parimi i ligjshmërisë, në kuptimin që organi kompetent ka detyrimin të hetojë nëse ka shkaqe të mjaftueshme për të besuar se ka ndodhur një shkelje disiplinore, si dhe parimi i “mosdënimit pa ligj”.

30.2. Lidhur me sa paraqitet më sipër nga ankuesi, Kolegji konstaton se nga dispozitat e ligjit nr. 96/2016, konkretisht të neneve 119-120, ILD-ja, gjatë paraqitjes së një ankese, verifikon paraprakisht kushtet formale të paraqitjes dhe pranueshmërisë së saj: [...] nga një subjekt i parashikuar në ligj, që gjatë ushtrimit të veprimtarisë ka mundësinë objektive të marrë të dhëna të besueshme për veprimtarinë e magjistratit, si dhe që të përmbajë të dhëna të qarta, të kuptueshme, dhe logjike, dhe të jetë në formën e kërkuar nga ligji. Bazuar në këtë vlerësim, si dhe pas një shqyrtimi fillestar të ankesës, ILD-ja merr vendimin për fillimin e hetimit disiplinor dhe shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes.

30.3. Për rastin e ankuesit, nga të dhënat që rezultojnë nga aktet, ILD-ja e ka filluar hetimin disiplinor bazuar në ankesën e paraqitur nga Ministria e Drejtësisë, nr. {***} prot., datë 20.2.2019, dhe aktet bashkëlidhur saj.

30.4. Ministria e Drejtësisë ka paraqitur si rrethana të faktit të shkeljes së pretenduar, ndër të tjera, se: [...] Në datën 24.07.2018, i dënuari G.Gj., bazuar në nenet 64 dhe 65 të Kodit Penal, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë me kërkesën me objekt: “Lirim me kusht” [...]. Në përfundim të gjykimit, gjyqtari Markelian Kuqo, me vendimin nr.{***}, datë 14.02.2019, ka vendosur: 1. Pranimin e kërkesës së kërkuarit G.Gj., me objekt: “Lirim me kusht”. 2. Lirimin me kusht të të dënuarit G.Gj., për pjesën e mbetur pa vuajtur të dënimit me burgim të përjetshëm, të caktuar në mbështetje të vendimit nr.{***}, datë 10.03.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke u vendosur në provë kërkuar për të gjithë jetën [...]. Referuar arsyetimit të vendimit dhe bazës ligjore të përmendur në vendimin e dhënë nga gjyqtari Markelian Kuqo, rezulton se gjyqtari ka vendosur pranimin e kërkesës dhe lirimin e menjëhershëm të tij, ndërsa i dënuari rezulton të jetë dënuar nga gjykatat italiane dy herë për vepra të ndryshme penale. Gjyqtari ka vendosur gjithashtu lirimin e të dënuarit me burgim të përjetshëm G.Gj., pa vuajtur ky i fundit 35 vite burgim, sikundërse parashikohet në nenin 65/2 të Kodit Penal, i ndryshuar me ligjin nr. 36, datë 30.03.2017, ndërsa gjyqtari në vendimin e tij ka argumentuar se i dënuari ka vuajtur 25 vite burgim. Plotësimi i kësaj periudhe burgimi parashikohej në nenin 65 të Kodit Penal para ndryshimeve të tij me ligjin nr. 36, datë 30.03.2017, si një ndër kushtet për lirimin me kusht të të dënuarve me burgim të përjetshëm. Ky interpretim i ligjit është kryer në shkelje të vendimit unifikues nr. 4, datë 27.03.2003, të Kolegjeve të Bashkuara, të Gjykatës së Lartë [...].

30.5. Nga ankesa që është paraqitur nga Ministria e Drejtësisë dhe aktet që kanë shoqëruar atë, rezulton se përveç se ajo është e plotësuar në elementet formale të saj, në të është dhënë dhe një përshkrim i rrethanave të faktit dhe të shkeljes që pretendohet të ketë ndodhur, në një nivel të

mjaftueshëm për të cilësuar të pranueshme ankesën dhe për të vënë në lëvizje ILD-në që të vlerësojë fillimin e një hetimi disiplinor, sipas parashikimeve të nenit 121 të ligjit nr. 96/2016.

30.6. Lidhur me pretendimin e ankuesit se është cenuar parimi i ligjshmërisë, në kuptimin që organi kompetent ka detyrimin të hetojë nëse ka shkaqe të mjaftueshme për të besuar se ka ndodhur një shkelje disiplinore, duhet pasur në konsideratë se detyrimi i organit kompetent, në këtë rast i ILD-së, që të vlerësojë dhe të hetojë nëse ka ndodhur një shkelje disiplinore, nuk kufizohet vetëm në momentin e pranimit të ankesës, por përgjatë gjithë veprimtarisë së tij, që nga marrja e vendimit për fillimin e hetimit disiplinor dhe deri në përfundimin e raportit të hetimit dhe vendimmarrjes për procedim të mëtejshëm ose mbylljen e hetimit.

30.7. Pavarësisht se shkak për fillimin e hetimit disiplinor është bërë ankesa e paraqitur nga Ministria e Drejtësisë, në vazhdim, siç rezulton nga aktet, ILD-ja ka kryer veprime të mëtejshme për mbledhjen e të dhënave dhe provave në funksion të procesit të hetimit. Kolegji konstaton se vendimmarrja e ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor nuk është bazuar vetëm mbi faktet e paraqitura nga ankuesi që ka iniciuar hetimin disiplinor, por mbi tërësinë e akteve të administruara dhe të shqyrtuara gjatë procesit të hetimit.

30.8. Në prapësimet e paraqitura në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, ILD-ja është shprehur se argumentet e dhëna në ankesën e ministrit të Drejtësisë kanë krijuar elemente të mjaftueshme juridike dhe rrethana të mjaftueshme faktike, të cilat, të shqyrtuara dhe të vlerësuara në tërësi, kanë krijuar në mënyrë të logjikshme dhe të paanshme standardin e dyshimit të arsyeshëm se shkelja disiplinore mund të jetë kryer. Për më tepër, në momentin e fillimit të hetimit disiplinor, ILD-ja ka pasur në dispozicion vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, të ndryshuar me vendimin e Gjykatës së Apelit Korçë, akte këto të vëna në dispozicion të këtij organi, në kuadër të inspektimit tematik që po zhvillohej në mbështetje të vendimit nr. 1, datë 11.2.2020, të ILD-së “Për kryerjen e inspektimit tematik të gjykatave dhe zyrave të prokurorive pranë tyre mbi trajtimin e kërkesave me objekt “lirim me kusht””.

30.9. Në vijim, rezulton se nga ana e ILD-së është kryer një proces i plotë hetimi disiplinor, gjatë të cilit janë administruar dhe analizuar të gjitha aktet, deklarimet dhe provat e nevojshme, të cilat vërtetuan ekzistencën e elementeve faktike dhe juridike që provojnë përgjegjësinë disiplinore të magistratit për shkelje të parashikuara nga neni 140, pika 2, shkronja “a” e Kushtetutës.

30.10. Në përfundim, për sa më sipër, Kolegji çmon se ILD-ja ka vepruar bazuar në diskrecionin që Kushtetuta dhe ligji i jep për fillimin dhe kryerjen e një procesi të plotë dhe të gjithanshëm hetimi në funksion të respektimit të procesit të rregullt ligjor. Rezulton se ILD-ja, në përmbushje të parashikimeve të neneve 119, 120, 121, 122 të ligjit 96/2016, ka analizuar kriteret e pranueshmërisë së ankesës, si dhe ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm për fillimin e hetimit disiplinor, për pasojë pretendimi i ankuesit për cenim të parimit të ligjshmërisë në këtë drejtim, është i pabazuar.

30.11. Sipas ankuesit, ministri i Drejtësisë, në ankesën që ka shërbyer si bazë për nisjen e hetimit disiplinor, në kundërshtim me parashikimet e nenit 120 të ligjit për statusin, ka parashikuar dhe propozuar masën disiplinore ndaj tij, duke u shprehur se: *Në përfundim të procedimit disiplinor, Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi të ketë shqyrtuar raportin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit të sipërcituar, të marrë masën disiplinore të “shkarkimit nga detyra, në bazë të nenit 140 të Kushtetutës, që do të thotë se ministri i Drejtësisë nuk e vendos në diskutim përfundimin që do të ketë raporti i hetimit disiplinor dhe urdhëron Këshillin të marrë masën disiplinore që propozon.*

30.12. Sipas ankuesit, referuar nenit 120 të ligjit nr. 96/2016, në asnjë rrethanë nuk parashikohet që ankuesi, në përmbajtje të kërkesës, të parashikojë apo propozojë masën disiplinore që kërkon ndaj magjistratit, duke mos qenë kjo rrethanë kusht për vlefshmërinë e ankesës, për pasojë, sipas tij: *[...] ILD gjendet [...] me doza të forta të paragjyqimit të konkluzionit [...] dhe me koncept të pritshmërisë së zgjidhjes pozitive të ankesës së ministrit të Drejtësisë.*

30.13. Kolegji vlerëson se edhe ky pretendim i ankuesit është i pabazuar, për sa kohë që nuk verifikohet asnjë rrethanë që të çojë në një përfundim të tillë dhe për shkak se ankuesi nuk ka arritur të provojë ndikimin që mund të ketë pasur propozimi i ministrit të Drejtësisë për masën disiplinore. ILD-ja ka diskrecionin dhe kompetencën që të kryejë verifikimet e nevojshme dhe në bazë të provave, si dhe të rezultatit të hetimit të propozojë masën disiplinore që gjykon se është e përshtatshme, dhe më pas KLGj-ja, gjatë procedimit disiplinor, të vendosë për çështjen. Nuk rezulton nga aktet e administruara që ILD-ja të ketë qenë nën ndikimin e masës së cituar prej ministrit të Drejtësisë në ankesë, por duket se në mënyrë të arsyeshme ILD-ja ka konkluduar për fillimin e procedimit disiplinor ndaj ankuesit dhe ka kërkuar vendosjen e masës së shkarkimit nga detyra, masë që përkon me atë të cituar në ankesë, por që mbështetet mbi një bazë të dhënash krejt të ndryshme që kanë rezultuar prej hetimit disiplinor.

31. Në lidhje me vendimin e ILD-së, nr. {***}, datë 2.4.2020, “Për fillimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit Markelian Kuqo”, ankuesi parashtroi se menjëherë pas njoftimit ka kundërshtuar përmbajtjen e tij, me shkresën nr. {***} prot., datë 24.4.2020, drejtuar ILD-së dhe për dijeni KLGJ-së, pasi:

- nuk ka arritur të perceptojë ligjshmërinë e veprimtarisë së ILD-së për fillimin e hetimit disiplinor në drejtim të respektimit të nenit 6 të KEDNJ-së për proces të rregullt;

- hetimi disiplinor është filluar në mënyrë të njëanshme dhe i ndikuar nga presioni mediatik dhe politik;

- nuk ka mundur të evidentojë specifikisht shkeljet që i janë atribuar dhe të perceptojë korrektësisht përmbajtjen e tyre;

- nuk ka qenë në gjendje të perceptojë/nuk janë saktësuar provat apo faktet që mbështesin paraprakisht dyshimin e arsyeshëm për fillimin e hetimit disiplinor;

- i është hequr e drejta të njihet me “akuzat” specifike paraprake dhe, për rrjedhojë, nuk i është dhënë mundësia për mbrojtje efektive.

31.1. Në përfundim, lidhur me përmbajtjen e vendimit të ILD-së, ankuesi pretendon se Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk ka ruajtur balancën për raportin fakt/analizë/konkluzion, duke i mëshuar vetëm konkluzionit dhe me doza të forta të paragjyqimit të tij. Sipas ankuesit, ILD-ja ka vepruar në kundërshtim me shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 100 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, duke cenuar parimin e akuzës, në kuptimin që çdo institucion shtetëror ose zyrtar duhet të veprojë kryesisht dhe të paraqesë një ankesë nëse ka prova të mjaftueshme për të besuar që ka ndodhur një shkelje disiplinore.

31.2. Lidhur me këto pretendime të ankuesit, Kolegji konstaton se ato i referohen “perceptimit” të ankuesit për veprimtarinë e ILD-së apo për shkeljet, provat dhe faktet e dala gjatë hetimit disiplinor, por jo me veprime/mosveprime konkrete të ILD-së, në shkelje të respektimit dhe garantimit të të drejtës së magjistratit për një proces të rregullt ligjor, si në drejtim të njohjes paraprake me materialet që e ngarkojnë me përgjegjësi, ashtu edhe në drejtim të respektimit të të drejtës për t’u mbrojtur me anën e dhënies së sqarimeve paraprake gjatë procesit të hetimit.

31.3. ILD-ja, në prapësimet ndaj pretendimeve të ankuesit, ka parashtruar se ankesa e paraqitur në ILD nga ana e Ministrit të Drejtësisë shoqërohet me një analizë të të gjithë informacionit të siguruar, në raport me disponimet ligjore në fuqi, që tregojnë se ka të dhëna të besueshme se ankuesi ka kryer shkelje disiplinore. Pavarësisht formulimit të bërë në ankesën e Ministrit të Drejtësisë, ILD-ja, në cilësinë e një organi kushtetues të pavarur, ka zhvilluar një hetim tërësisht të pavarur nga përfundimet e Ministrit të Drejtësisë. Të dhënat e Ministrit të Drejtësisë kanë shërbyer vetëm si bazë për fillimin e hetimit disiplinor, ndërkohë që i gjithë procesi i hetimit është kryer në pavarësi dhe paanësi të plotë nga ILD-ja, duke respektuar plotësisht parimet dhe procedurat e parashikuara nga ligji, me një analizë ligjore të fakteve rrethanave dhe parashikimeve ligjore.

31.4. Bazuar në argumentet e paraqitura më sipër, nuk qëndron edhe pretendimi i ankuesit për cenim të parimit të akuzës, për shkak se hetimi disiplinor është filluar në mënyrë të njëanshme dhe i ndikuar nga presioni mediatik dhe politik, për sa kohë ai ka filluar mbi të dhëna të vlerësuara të mjaftueshme brenda pushtetit diskrecionar të ILD-së.

31.5. Për sa i përket pretendimit të ankuesit se i është hequr e drejta të njihet me akuzat specifike paraprake dhe, për rrjedhojë, nuk i është dhënë mundësia për mbrojtje efektive, konstatohet se ai ka marrë dijeni menjëherë për fillimin e hetimit, pasi nga ILD-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 2.04.2020, i është njoftuar vendimi për fillimin e hetimit disiplinor, si dhe i janë bërë me dije të drejtat dhe detyrimet, midis të cilave edhe e drejta e aksesit në dosjen e hetimit. Gjithashtu, ankuesi ka pasur mundësinë, që edhe gjatë procesit të zhvilluar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, të njihet me Raportin dhe materialet e hetimit, si dhe të paraqesë argumentet për mbrojtjen e tij. Pra, edhe ky pretendim i ankuesit rezulton të jetë i pabazuar.

32. Sipas ankuesit, ILD-ja, në këndvështrim të nenit 124 të ligjit nr. 96/2016, nuk rezulton të ketë pasur të dhëna thelbësore mbi fakte që rezultojnë nga burime të besueshme, mbi bazën e të cilave lind dyshimi i arsyeshëm se shkelja mund të jetë kryer, si dhe nuk arriti të provojë para Këshillit të Lartë Gjyqësor ligjshmërinë e procesit, duke cenuar në këtë mënyrë parimin e prezumimit të fajësisë dhe atë të barazisë para ligjit, të sanksionuara në shkronjat “ç” dhe “d”, të pikës 1, të nenit 100 të këtij ligji, si dhe parimin e procesit të rregullt ligjor, të zhvilluar tërësisht në mungesë të parimit të kontradiktoritetit dhe drejtësisë së hapur.

32.1. Ankuesi parashtron se vendimi i ILD-së për fillimin e hetimit disiplinor është mbështetur në nenet 123 dhe 124 të ligjit për statusin, ku neni 123 referon për fillimin e hetimit disiplinor mbi ankesë, kurse neni 124 për fillimin e hetimit disiplinor me iniciativën e vetë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Në përmbajtjen e vendimit për fillimin e hetimit disiplinor nuk ekziston asnjë rrethanë mbi të cilën të sqarohet apo të argumentohet fillimi i hetimit me iniciativën e vetë Inspektorit.

32.2. Nga aktet në dispozicion, rezulton që hetimi disiplinor është iniciuar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga Ministria e Drejtësisë, nr. {***} prot., datë 20.02.2019, regjistruar pranë ILD-së me nr. {***} prot., datë 25.02.2020.

32.3. Ndërkohë, ILD-ja, nëpërmjet vendimit nr. 1, datë 11.02.2020, ka vendosur kryerjen e inspektimit tematik të gjykatave dhe të zyrave të prokurorëve për trajtimin e kërkesave me objekt “Lirim me kusht”, nëpërmjet të cilit është vënë në dijeni të faktit se vendimi nr. {***}, datë 14.2.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë është ndryshuar me Vendimin nr. {***}, datë 26.6.2019, të Gjykatës së Apelit Korçë.

32.4. Në këto kushte, Kolegji çmon se pavarësisht se hetimi disiplinor mund të ketë filluar me ankesë të një prej subjekteve që e kanë këtë të drejtë, legjislacioni nuk e përjashton rastin që dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bazuar në të dhëna dhe prova të mëtejshme të bashkohet me iniciativë për fillimin e hetimit. Në nenin 128 të ligjit nr. 96/2016 parashikohet se: *“Inspektori i Lartë i Drejtësisë bashkon procedimet, në rastet kur konstaton se ankesat ose hetimet e filluara u referohen të njëjtave fakte ose të njëjtit magjistrat”*. Përdorimi i të dhënave që vijnë jo vetëm nga ankesa e Ministrit të Drejtësisë, por edhe nga rezultatet e inspektimit tematik, nuk konsiderohet se shkel ndonjë të drejtë të magjistratit, përderisa, për të gjitha gjetjet ai i nënshtrohet hetimit disiplinor përgjatë të cilit ai gëzon të gjithë të drejtat e parashikuara nga ligji. Kolegji vlerëson se ligji ka lënë në diskrecion të ILD-së se mbi ç’bazë do të nisë hetimin disiplinor, duke pasur si qëllim që ky organ të ushtrojë të gjithë kompetencat e tij ligjore për të garantuar evidentimin dhe ndjekjen disipline të magjistratëve, të cilët rezultojnë se shkelin ligjin përgjatë veprimtarisë së tyre.

32.5. Në këtë vështrim, Kolegji çmon se pretendimet e ankuesit, për bazën ligjore me të cilën është filluar hetimi, është i pabazuar dhe në këtë drejtim nuk konstatohet asnjë shkelje e procesit të rregullt, për sa kohë që nga ILD-ja rezulton të jenë respektuar të gjithë hapat procedurale të parashikuara në legjislacionin në fuqi për fillimin e hetimit disiplinor.

33. Ankuesi pretendon se gjatë zhvillimit të hetimit disiplinor nga ILD-ja ka pasur mungesë ndërveprimi të ILD-së me të, i detyrueshëm, sipas parashikimeve të neneve 129, 130 dhe 131 të ligjit nr. 96/2016.

33.1. Nga verifikimi i akteve në fashikujt e përcjellë nga KLGj-ja, Kolegji konstaton se, me shkresën nr. {***} prot., datë 02.04.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ankuesi është njoftuar për vendimin nr. {***} prot., datë 02.04.2020, “Për fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit Markelian Kuqo, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë”. Në njoftimin e vendimit të mësipërm, ankuesit, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative, i janë bërë të ditur edhe të drejtat dhe detyrimet e tij gjatë procedurës së hetimit disiplinor.

33.2. Ankuesi, me shkresë nr. {***} prot., datë 24.04.2020, regjistruar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me nr. {***} prot., datë 28.04.2020, ka paraqitur parashtesat përkatëse, si dhe ka kërkuar të njihet me disa akte, të cilat i janë vënë në dispozicion nga ILD-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 11.05.2020, në adresën e deklaruar prej tij.

33.3. Me qëllim dhënien e kohës së nevojshme për t’u njohur me aktet, si dhe për të realizuar një mbrojtje efektive, me vendimin nr. {***}, datë 01.06.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, afati fillestar dymujor për përfundimin e hetimit është zgjatur me tre muaj të tjerë. Ky vendim i është njoftuar ankuesit me shkresën nr. {***} prot., datë 02.06.2020, të ILD-së.

33.4. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se pretendimet e ankuesit, për mungesë ndërveprimi me ILD-në gjatë procesit të hetimit disiplinor, rezultojnë të jenë të pabazuara.

34. Ankuesi ka parashtruar në Kolegj se nuk i është vënë në dispozicion Raporti i Hetimit nga ILD-ja në momentin e përfundimit të hetimit, por as nga KLGJ-ja, në fazën e veprimeve paraprake në Komisionin Disiplinor.

34.1. Nga aktet konstatohet se në seancën e parë dëgjimore të datës 2.10.2020 (sipas procesverbalit të mbledhjes së KLGJ-së) ankuesi ka paraqitur ankesë se nuk ka pasur dijeni për Raportin e Hetimit, që nuk i është komunikuar nga ILD-ja dhe se nuk ka pasur asnjë komunikim të drejtpërdrejtë të fakteve dhe rrethanave për të cilat ndodhet në procedim disiplinor. Sipas tij, asnjë dokument nuk e vërteton që ky akt (raporti) i është komunikuar.

34.2. Lidhur me këtë kërkesë, Inspektori i Lartë, në prapësimet e paraqitura në Kolegj, shprehet se pretendimi për mosvënien në dispozicion të njoftimit për përfundimin e hetimeve dhe Raportit të Hetimit është një pretendim që nuk gjen mbështetje në parashikimet e bëra nga ligji nr. 96/2016, i cili nuk referon në asnjë dispozitë të tij detyrimin për njoftimin e raportit që përgatitet nga ILD-ja në përfundim të hetimeve.

34.3. Lidhur me sa më sipër, Kolegji tërheq vëmendjen se pavarësisht se dispozitat e ligjit nr. 96/2016 nuk parashikojnë shprehimisht detyrimin e ILD-së për të vënë në dispozicion të

magjistratit Raportin e Hetimit, në nenin 129, pika 1 të ligjit është parashikuar se magjistratit, si palë në proces, i garantohet aksesin në dosjen e hetimit që nga momenti i fillimit të hetimit dhe në atë masë që është në përputhje me objektin e hetimit. Njohja e magjistratit me dosjen e hetimit, pra, me të gjithë provat dhe dokumentacionin mbi të cilin justifikohet fillimi i hetimit dhe propozohet marrja e masës disiplinore, është me rëndësi në kuadër të respektimit të barazisë së armëve në një proces të rregullt ligjor. Edhe Raporti i Hetimit, pavarësisht mungesës së detyrimit ligjor eksplicit për njoftimin e tij, si pjesë e dokumentacionit të hetimit dhe si akti përfundimtar duhet t'i njoftohet magjistratit, i cili ka të drejtë të njihet me rezultatet e procesit të hetimit ndaj tij për realizimin e një mbrojtjeje efektive në vazhdim të procedimit disiplinor.

34.4. Ndërsa, për sa i përket detyrimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor për t'i vënë në dispozicion magjistratit aktet e dosjes së procedimit disiplinor, rezultojnë se Rregullorja e KLGj-së "Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor", në nenin 32, parashikon: "*1. Relatori, me njoftimin e vendimit të Këshillit për caktimin e seancës dëgjimore, i bën të ditur magjistratit të drejtat, si vijon: a) për t'u njohur me dokumentet e dosjes dhe për të marrë kopje të tyre, brenda pesë ditëve nga paraqitja e kërkesës së tij [...]*".

34.5. Sipas këtij parashikimi, magjistrati ka të drejtë të njihet me dosjen e përcjellë në KLGj, si dhe të marrë kopje të akteve që janë pjesë e dosjes, në të cilën përfshihet edhe Raporti i Hetimit, si dhe procesverbali i hetimit, sipas nenit 30/1 të Rregullores që referon në nenin 133 të ligjit nr. 96/2016, për dokumentacionin e hetimit.

34.6. Siç rezultojnë edhe nga aktet, ankuesi është njohur me Raportin e Hetimit gjatë seancës dëgjimore të datës 2.10.2020, në KLGj, dhe ka kërkuar kohë për t'u njohur me aktin dhe shqyrtjen e seancës dëgjimore, kërkesa që i janë pranuar nga Këshilli.

34.7. Sa më sipër, në përfundim, Kolegji çmon se pavarësisht vënies në dispozicion me vonesë të Raportit të Hetimit, ankuesi ka marrë dijeni efektivisht për të dhe KLGj-ja, duke shqyrtuar seancën dëgjimore, i ka dhënë atij kohën e nevojshme për t'i garantuar të drejtën për t'u njohur me rezultatet e hetimit dhe për t'u mbrojtur ndaj konkluzioneve të nxjerra në raport. Ndonëse ILD-ja nuk ka vënë në dispozicion të ankuesit Raportin e Hetimit me marrjen e vendimit për fillimin e procedimit disiplinor, efektivisht, kjo mangësi nuk provohet të ketë pasur ndonjë ndikim të pariparueshëm në drejtësi të procesit të rregullt ligjor, për sa kohë që vetë KLGj-ja e ka shëruar atë me shqyrtjen e seancës dhe dhënien e kohës për përgatitje. Në këto kushte, ky pretendim i ankuesit vlerësohet si i pabazuar në tërësinë e tij.

35. Ankuesi parashtron se Komisioni Disiplinor pranë KLGj-së duhet të evidentonte të metat në kërkesën e ILD-së, bazuar në parashikimet e nenit 133 të ligjit nr. 96/2016, lidhur me dokumentacionin e hetimit, si dhe me zgjerimin e objektit të hetimit. Komisioni Disiplinor dhe relatori nuk kanë vepruar për ezaurimin dhe zgjidhjen e ankesave të ankuesit në procedimin disiplinor, për mosveprim, për kthim dhe administrim provash, si dhe për pranimin ose jo të kërimit për thirrjen e dëshmitarit që në fazën paraprake të procesit. Sipas ankuesit, Raporti i

Hetimit i paraqitur nga ILD-ja është depozituar në KLGj i paarsyetuar dhe i paverifikuar nga Këshilli për këtë aspekt të detyrueshëm për verifikim.

35.1. Në shqyrtim të këtyre pretendimeve rezulton se, sipas neneve 30-33 të Rregullores së KLGj-së, “Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, në të cilat parashikohen procedurat për shqyrtimin paraprak të kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor, Komisioni Disiplinor dhe relatori i caktuar me short bëjnë vetëm verifikimin e kritereve formale të kërkesës së ILD-së, sipas nenit 133 të ligjit nr. 96/2016, si dhe kryejnë veprimet paraprake për përgatitjen e seancës dëgjimore.

35.2. Nga përmbajtja e nenit 33 të Rregullores rezulton se Komisioni Disiplinor dhe relatori kujdesen për : “*ç) marrjen e vendimeve nga mbledhja plenare e Këshillit, për: pranueshmërinë e provave; thirrjen, angazhimin e ekspertëve dhe përcaktimin e detyrave të tyre, kur e konsideron të përshtatshme ose kërkon nga ILD-ja thirrjen e ekspertëve; marrjen e provave shtesë, duke përfshirë edhe thirrjen e dëshmitarëve; kryerjen e hetimeve të mëtejshme nga ILD-ja, duke specifikuar elementët që mungojnë dhe afatin; paraqitjen nga ana e magjistratit të të dhënave, dokumenteve ose çdo lloj prove si marrjen pjesë të tij në seancë dëgjimore në trajtimin e çështjes*”.

35.3. Është i qartë nga ky formulim i dispozitës që Komisioni Disiplinor dhe relatori, gjatë veprimeve paraprake për përgatitjen e çështjes për seancë dëgjimore, përgatisin dhe paraqesin në relacion çështjet për të cilat do të ketë vendimmarrje nga mbledhja plenare e Këshillit dhe nuk u japin zgjidhje ankesave apo kërkesave të magjistratit, por vendosin vetëm për përcjelljen e tyre mbledhjes plenare të Këshillit.

35.4. Gjithashtu, konstatohet se KLGj-ja në vendim ka bërë dhe një vlerësim të Raportit të Hetimit, duke u shprehur se: “[...].*Bashkë me kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor, në Këshill është depozituar edhe raporti i hetimit i miratuar nga Inspektori, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 3 e ligjit ‘Për statusin’.* Referuar këtij parashikimi ligjor, Këshilli ka vlerësuar se raporti i hetimit është depozituar i arsyetuar në të gjithë elementët formalë të kërkuar nga kjo dispozitë”.

35.5. Sa më sipër, Kolegji çmon se, sipas parashikimeve ligjore në fuqi, KLGJ-ja ka vlerësuar në tërësi kërkesat e ankuesit për procedurën e ndjekur dhe dokumentacionin e paraqitur nga ILD-ja në kuadër të procedimit disiplinor.

36. Ankuesi pretendon se nuk i është dhënë mundësia për t’i kërkuar Mbledhjes Plenare të KLGj-së mbylljen e procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore, për të paraqitur ankim ndaj vendimeve të Komisionit, si dhe për të kërkuar përjashtimin e anëtarëve të KLGj-së, të drejta që ushtrohen sipas tij vetëm në fazën paraprake të procesit disiplinor.

36.1. Lidhur me pretendimin për mbylljen e procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore, Kolegji vëren se, sipas nenit 139 të ligjit nr. 96/2016, Këshilli vendos mbylljen e procedimit disiplinor në rastet kur: “*a) shkelja disiplinore është parashkruar në kohën kur ka filluar hetimi, sipas parashikimeve të nenit 117 të këtij ligji; b) çështja ka qenë objekt i procedimit disiplinor që është*

zgjdhur me vendim të formës së prerë; c) ka arsye të tjera për të mbyllur procedimin, në përputhje me parashikimet e nenit 134, pika 1, shkronjat “ç” dhe “d” [magjistratit i mbaron statusi ose ka vdekur];ç) raporti i hetimit është depozituar pa u arsyetuar”.

36.2. Nga aktet në fashikuj, rezulton se Komisioni Disiplinor në KLGj ka kryer verifikimin e kriterëve formale të kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor, duke vlerësuar midis të tjerave dhe kushtet e parashikuara në nenin 139 të ligjit nr. 96/2016, për mbylljen e procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore. Në përfundim, Komisioni Disiplinor ka vlerësuar se nuk verifikohet asnjë nga kushtet e parashikuara në nenin 139 të ligjit nr. 96/2016. KLGJ-ja, me Vendimin nr. 334, datë 17.09.2020, mbi propozimin e relatorit të çështjes, duke i vlerësuar si të plota veprimet paraprake të kryera nga Komisioni Disiplinor, ka vendosur kalimin e çështjes në seancë dëgjimore. Gjithashtu, KLGj-ja, bazuar në nenin 133, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, ka vlerësuar se Raporti i Hetimit i ILD-së është depozituar i arsyetuar në të gjithë elementët formalë të kërkuar nga kjo dispozitë.

36.3. Për sa më sipër, në mungesë të verifikimit të kushteve të parashikuara nga ligji, për mbylljen e procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore, Kolegji vlerëson se pretendimi i ankuesit në këtë drejtim nuk qëndron.

36.4. Për sa i përket pretendimit se nuk i është dhënë mundësia për të paraqitur ankim ndaj vendimeve të Komisionit dhe për të kërkuar përjashtimin e anëtarëve të KLGJ-së, Kolegji, bazuar në aktet, si dhe sipas prapësimeve të paraqitura nga KLGJ-ja, konstaton se këto kërkesa nuk janë paraqitur nga ankuesi në asnjë nga fazat procedurale para, si dhe gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore në Këshill. Për këtë arsye, Kolegji vlerëson se ankuesi nuk mund të paraqesë para Kolegjit, pretendime të cilat ai nuk i ka ngritur dhe, për pasojë, nuk i janë nënshtruar shqyrtimit dhe vlerësimit të organit kompetent, KLGJ-së, gjatë procedimit disiplinor. Vetëm pretendimi për një pamundësi hipotetike, nuk përlligj pretendimin e ankuesit të ngritur para Kolegjit për shkeljen e së drejtës, për sa kohë nuk provohet se situata e shkeljes ka ndodhur realisht.

37. Sipas ankuesit, KLGj-ja në seancë dëgjimore nuk është shprehur për pranueshmërinë e provave të paraqitura prej tij, ndërkohë që për provat e paraqitura para fazës së zhvillimit të seancës dëgjimore, Këshilli është shprehur në seancën dëgjimore me vendimmarrjet përkatëse për pranimin ose jo të tyre, duke krijuar një standard të dyfishtë procedural, pasi për çdo provë të kërkuar, Këshilli, duhet të ishte shprehur me vendim për pranimin ose jo të tyre, në drejtim të garantimit të një procesi të rregullt ligjor.

37.1. Kolegji vëren se ky pretendim i ankuesit nuk është i bazuar. Nga procesverbali i seancës dëgjimore të datës 26.11.2020 në KLGj, pas kërkesës së ankuesit për të administruar në cilësinë e provës, dosjen e plotë të procedimit disiplinor, përfunduar me vendimin nr. 89, datë 07.07.2014, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, rezulton se: *“Këshilli vendosi: Mospranimin e kërkesës së magjistratit {...} për administrim në cilësinë e provës shkresore të dosjes së plotë të procedimit disiplinor përfunduar me vendimin nr. 89, datë 07.07.2014, të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë,*

me arsyetimin se materialet e procedimit të mëparshëm disiplinor nuk janë pjesë e dosjes personale dhe të dhënat që ato sjellin kapërcejnë objektin e këtij shqyrtimi”.

38. Në përmbledhje të sa është analizuar më sipër, Kolegji konstaton, nga aktet në fashikuj, se janë respektuar të drejtat procedurale të ankuesit në drejtim të njoftimit, të njohjes me aktet, si dhe të përgatitjes së mbrojtjes, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, pasi:

38.1. Me shkresën nr. {***} prot., datë 2.04.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është njoftuar ankuesi për fillimin e hetimit të procedimit disiplinor dhe kjo provohet edhe nga kthimi i përgjigjes nga ankuesi në datën 28 prill 2020.

38.2. Me shkresën nr. {***} prot., datë 11.05.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i janë përcjellë ankuesit provat e rezultuara nga hetimi.

38.3. Me shkresën nr. {***} prot., datë 18.09.2020, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor i është njoftuar vendimi nr. 334, datë 17.09.2020, i KLGJ-së, për zgjatjen e afatit të shqyrtimit të kërkesës së ILD-së, për fillimin e procedimit disiplinor ndaj tij, si dhe caktimin e datës 2 tetor 2020, si datë e zhvillimit të seancës dëgjimore. Njëkohësisht, me këtë njoftim, sipas nenit 141, paragrafi 2 të ligjit nr. 96/2016, subjektit i janë bërë të ditura të drejtat e tij në këtë procedim, duke i lënë edhe një afat deri më 28.09.2020, për të paraqitur parashtresat me shkrim.

38.4. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka zhvilluar 6 seanca dëgjimore me ankuesin në funksion të zhvillimit të procedurës disiplinore ndaj tij, në të cilat janë pranuar edhe disa kërkesa të tij për shtyrje seance për t’u njohur me materialet, si dhe për të përgatitur mbrojtjen.

39. Në përfundim, për sa më sipër, Kolegji vlerëson se pretendimet e paraqitura nga ankuesi për shkelje procedurale gjatë fazës së hetimit dhe procedimit disiplinor, që sipas tij kanë sjellë shkelje të procesit të rregullt ligjor, janë të pabazuara. Ankuesit i është dhënë mundësia të parashtrorë pretendimet e tij dhe të paraqesë provat në mbrojtje të këtyre pretendimeve, për të cilat KLGj-ja, në përfundim të procesit, me vendim të arsyetuar, është shprehur mbi mënyrën e vlerësimit të tyre. Edhe mosnjoftimi i Raportit të Hetimit nga ana e ILD-së në fazën e hetimit nuk ka rezultuar me pasoja të qenësishme në drejtim të të drejtës së ankuesit për t’u njohur me aktet, pasi kjo mangësi është korrigjuar në fazat e mëtejshme të procedimit disiplinor në KLGj. Në këtë kontekst, në kundërshtim nga sa pretendon ankuesi, procesi disiplinor nuk mund të konsiderohet si i parregullt.

B2. Lidhur me shkaqet e ankimit për Vendimin nr. 633, datë 10.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor

40. Ankuesi pretendon se vendimi i KLGJ-së paraqitet i paarsyetuar, lidhur me detyrimin që ka për të parashtruar dhe vlerësuar me argument specifik të kundërtën e argumenteve të parashtruara nga magjistrati. Ankuesi ka paraqitur një tërësi argumentesh kundër veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në drejtim të paligjshmërisë së fillimit të procesit hetimor, procedurës së ndjekur dhe

përmbajtjes, argumente këto të cilat nuk gjenden të relatuara, të trajtuara, të vlerësuara dhe çmuara nga ana e KLGj-së.

40.1. Lidhur me këtë pretendim të ankuesit, Kolegji konstaton nga përmbajtja e vendimit të KLGj-së objekt ankimi se në paragrafët 4, 5, 6 dhe 7 janë evidentuar të gjithë hapat proceduralë të kryer nga ILD-ja, në kuadër të fillimit të hetimit disiplinor, si dhe të paraqitjes së kërkesës për procedim disiplinor ndaj ankuesit në KLGj. Gjithashtu, në vendim janë të pasqyruara, në pjesën IV, parashtrimet e ankuesit në të cilat janë përfshirë dhe argumentet dhe pretendimet e tij në lidhje me veprimtarinë e ILD-së. Në analizë të vendimit, Kolegji konstaton dhe se janë vlerësuar nga KLGj-ja pretendimet e ankuesit në drejtim të procedurave të hetimit të kryer nga ILD-ja dhe është argumentuar bazueshmëria e tyre, sipas parashikimeve të ligjit nr. 96/2016.

40.2. Kolegji sjell në vëmendje se GjEDNJ-ja, në jurisprudencën e saj, ka nënvizuar se *detyrimi i gjykatave për të arsyetuar vendimet e tyre, nuk do të thotë dhënie përgjigjeje për çdo çështje/argument, të ngritur nga pala për të mbështetur mbrojtjen e saj. Fushë veprimi/shtrirja e këtij detyrimi mund të ndryshojë në varësi të natyrës së vendimit. Për të respektuar parimin e procesit të rregullt ligjor, arsyetimi duhet të demonstrojë që gjyqtari/gjykata ka shqyrtuar realisht të gjitha çështjet kryesore që janë ngritur përpara tij/saj¹.*

40.3. Për sa më sipër, Kolegji çmon se KLGJ-ja ka përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për pasqyrimin dhe vlerësimin e pretendimeve të ankuesit, sipas diskrecionit të vetë organit. Fakti që qëndrimet e mbajtura nga KLGj-ja nuk i përgjigjen pritshmërisë së ankuesit, nuk zhbëjnë faktin e trajtimit të tyre. Në këto rrethana, pretendimet e ankuesit sa më lart, konsiderohen se janë të pabazuara.

41. Sipas ankuesit, vendimi i KLGj-së paraqitet i paarsyetuar në drejtim të argumentimit të rrëzimit të kërkesave të tij për thirrjen e dëshmitarit dhe të administrimit në cilësinë e provës të praktikës së procedimit të Komisionit të Mbrojtjes së Gjyqtarëve.

41.1. Lidhur me këtë pretendim të ankuesit konstatohet se në Vendimin nr. 633, datë 10.12.2020, KLGj-ja është shprehur se: *“65.1. Konkretisht në seancën dëgjimore të datës 30.09.2020, Këshilli ka vendosur: (i) Mospranimin e kërkesës për caktimin e përkthyesve për përkthimin e vendimeve të GJEDNJ-së të listuara, pasi qëndrimet e GJEDNJ-së përbëjnë jurisprudencë, e cila është e njohur nga të gjitha organet që përbëjnë rendin e brendshëm juridik të një shteti palë të konventës dhe, për rrjedhojë, mund të referohen në çdo rast nga palët, por nuk përbëjnë provë në kuadër të procedimit. (ii) Mospranimin e kërkesës për thirrjen në cilësinë e dëshmitares të shtetases znj. Etilda Gjonaj, me detyrë Ministër i Drejtësisë, pasi vlerësohet se është e panevojshme në lidhje me objektin e procedimit. (iii) Mospranimin e kërkesës për administrimin e plotë të dosjes të Komisionit të Mbrojtjes së Gjyqtarëve, pasi vlerësohet se është e panevojshme në lidhje me objektin e procedimit”.*

¹ Shih çështjet *Boldea kundër Rumanisë*, 15 shkurt 2007 § 29 dhe *Helle kundër Finlandës*, 19 shkurt 1997, § 60.

41.2. Nga përmbajtja e vendimit, rezulton se KLGj-ja, brenda diskrecionit që ka si organ kushtetues-administrativ, në përputhje me nenin 146 të ligjit nr. 96/2016, duke vlerësuar kërkesat e ankuesit, ka vendosur dhe argumentuar mospranimin e tyre. Mungesa e plotësisë së argumentit të pretenduar prej ankuesit, lidhet sipas Kolegjit, me vlerësimin që ka bërë KLGJ-ja rast pas rasti, të tërësisë së kërkesave të paraqitura nga ankuesi përgjatë procedimit disiplinor, si dhe me rëndësinë që kanë pasur këto kërkesa për zgjidhjen në themel të çështjes objekt shqyrtimi. Ndërsa konstatohet se vendimi i mësipërm i KLGj-së është i shoqëruar me argumentet e konsideruara prej organit në një nivel që nuk e bëjnë vendimin të paarsyetuar, Kolegji konkludon se është i pabazuar pretendimi i ankuesit se në përmbajtjen e vendimit të KLGj-së nuk ekziston i pasqyruar dhe nuk është dhënë asnjë argument se përse kërkesat e tij janë rrëzuar.

42. Ankuesi parashtron se Gjykata e Apelit Korçë nuk ka paraqitur asnjë argument të vetëm në arsyetimin e saj se përse në zgjidhjen e çështjes ankuesi duhej të ishte mbështetur në sanksionin e nenit 64, paragrafi 3 të Kodit Penal. Vetë Inspektori i Lartë i Drejtësisë për asnjë rast nuk paraqiti para KLGj-së asnjë argument teorik apo të praktikës gjyqësore që të referonte apo konkretizonte bindjen e tij se ankuesi gjendet në shkelje për moszbatimin e nenit 64, paragrafi 3 të Kodit Penal. Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk ka parashtruar në përmbajtje të vendimit objekt shqyrtimi, asnjë argument të kundërt në këtë drejtim, përveçse atij se neni 64 ka lidhje me nenin 65 të Kodit Penal, pasi të dy dispozitat flasin për lirimin me kusht. Gjithashtu, ankuesi pretendon se çmuarja, nëse moszbatimi i nenit 64, pika 3 të Kodit Penal përbën ose jo shkelje të ligjit, nuk është në kompetencën vlerësuese të ILD-së apo të vetë KLGj-së, për sa kohë kompetenca për gjykim dhe vlerësim i përket Gjykatës së Lartë, si gjykatë e mirëfilltë ligji.

42.1. Lidhur me këto pretendime të ankuesit, Kolegji, në referim të dispozitave ligjore, si dhe bazuar në aktet, konstaton se:

42.1.1. Neni 64, paragrafi 3 i Kodit Penal, parashikon se: *“Nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje, si dhe për të dënuarin për kryerjen e veprave penale të parashikuara në nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c apo paragrafi i tretë i nenit 100”*.

42.1.2. Nga vendimi nr. {***}, datë 14.2.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, rezulton se i dënuari G. Gj. është dënuar me vendim të Gjykatës së Milanos, me 1 vit e 6 muaj burgim dhe 500.000 lireta gjobë për veprën penale “Falsifikim i dokumenteve”, vendim i cili ka marrë formë të prerë në datën 20.01.2007. Gjithashtu, i dënuari G. Gj. është dënuar me vendim të Gjykatës për Krime të Rënda Milano, me burgim të përjetshëm, si dhe ndaj tij janë dhënë dënime plotësuese “Përjashtim i përhershëm nga zyrat publike” dhe “Izolim për 17 muaj”, pasi është deklaruar fajtor për veprat penale: Vrasje me paramendim në dy raste; Mbatje e armëve luftarake; Prodhim dhe shitje e narkotikëve; Kryerje e krimeve nga banda e armatosur. Ky vendim ka marrë formë të prerë, me vendimin e datës 2.02.2001, të Gjykatës së Apelit Milano.

42.1.3. Këto dënime janë bashkuar me vendimin nr. 73/2002, të Prokurorisë së Milanos, duke disponuar përfundimisht dënimin e G. Gj. me dënimin kompletiv: *“Burgim të përjetshëm;*

500.000 lireta gjobë, konvertuar në euro; Përrjashtim nga zyrrat publike; 17 muaj izolim; Ky dënim fillon nga data 13.02.1998 dhe nuk skadon kurrë”.

42.1.4. Ky fakt ka rezultuar edhe nga Vendimi nr. {***} akti, datë 10.03.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për njohjen e vendimit penal të huaj ndaj shtetasit G. Gj., me anë të të cilit është vendosur: *“Njohja e vendimit penal të huaj, datë 20.01.1997, të Gjykatës Milano Itali, i cili ka marrë formë të prerë në datën 16.03.1997 dhe vendimit nr. {***}, datë 21.12.1999, të Gjykatës për Krimet e Rënda Milano Itali, i cili ka marrë formë të prerë në datën 02.02.2001, nga Gjykata e Apelit Milano Itali, të cilët janë bashkuar me vendimin nr. {***}, të Prokurorisë Milano, për të dënuarin G. Gj.. Bazuar në nenin 516 të Kodit të Procedurës Penale, konvertimin e dënimeve të marra prej të dënuarit G. Gj. dhe caktimin ndaj tij të një dënimi të vetëm, atë me burgim të përjetshëm”.*

42.1.5. Gjykata e Apelit Korçë, në vendimin nr. {***}, datë 26.06.2019, pasi u është referuar vendimeve të gjykatave të huaja, si dhe vendimit nr. {***} akti, datë 10.03.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për njohjen e vendimit penal të huaj, ka arsyetuar se: *“Konstatohet se Gjykata e Shkallës së Parë Korçë në pjesën hyrëse të vendimit citon vendimet e dhëna në shtetin italian ... dhe nuk përmend faktin se i dënuari G. Gj. është përsëritës në kryerjen e veprave penale të kryera me dashje [...] pra, siç shihet i dënuari G. Gj. ka qenë përsëritës në krime të kryera me dashje dhe ky fakt ka qenë kusht ndalues për aplikimin e nenit 64 të Kodit Penal... Në kuptim të kërkesave të nenit 64 të Kodit Penal, ekziston pengesa ligjore e parashikuar nga kjo dispozitë, pasi kërkuesi është përsëritës në kryerjen e veprave penale me dashje. Fakti se atij më pas i janë bashkuar të dy vendimet penale të mësipërme, nuk do të thotë se ai nuk është përsëritës”.*

42.2. Sa më sipër, Kolegji vëren se ndryshe nga sa pretendon ankuesi, Gjykata e Apelit Korçë është shprehur dhe ka argumentuar qëndrimin e mbajtur nga ankuesi në lidhje me zbatimin jo të drejtë të kushtit përjashtues për të përfituar nga lirimi me kusht të të dënuarit përsëritës për krime të kryera me dashje.

42.3. Gjithashtu, Kolegji konstaton si të drejtë qëndrimin e mbajtur nga KLGJ-ja, e cila në vendim është shprehur se: *“...arsyetimi i bërë nga ana e magjistratit nuk është bërë në përputhje me provat e administruara në gjykim dhe në përputhje me faktet dhe rrethanat që janë provuar gjatë procesit gjyqësor, si dhe faktet dhe rrethanat janë parashtruar dukshëm në mënyrë të shtrembëruar dhe vetëm për t’ju përshtatur plotësimin të kërkesave formale (me natyrë objektive), si dhe atyre me natyrë subjektive të neneve 64 dhe 65 të Kodit Penal [...]”.* Nga vendimi gjyqësor Kolegji konstaton se ankuesi, pasi citon vendimet e dhëna në shtetin italian ndaj të dënuarit G. Gj., i referohet vetëm bashkimit të këtyre dy dënimeve nga Prokuroria e Milanos, pa bërë një analizë të veprave penale dhe duke anashkaluar faktin se kërkuesi është dënuar dy herë dhe rezulton të jetë përsëritës për vepra penale të kryera me dashje, duke konkluduar se kërkuesi në respektim të kërkesave formale të neneve 64 dhe 65 të Kodit Penal, plotëson kriteret formale të ligjit për paraqitjen e kërkesës për lirim me kusht, si dhe nuk paraqitet i dënuar për krime të kryera me dashje apo vepra të tjera penale, përveç këtyre që paraqiten.

42.4. Për sa i përket pretendimit të ankuesit se kompetenca për gjykim dhe vlerësim për këtë aspekt i përket Gjykatës së Lartë, si gjykatë e mirëfilltë ligji, Kolegji sjell në vëmendje se Gjykata e Lartë, në vendimin nr. {***} i Vendimit {***}, datë 14.06.2022, në çështjen me kërkues G. Gj., është shprehur se: “[...] ligji vendos disa kritere ndaluese në lidhje me zbatimin e dënimit alternativ të lirimit me kusht, ekzistenca e një/disë prej të cilave shkakton humbjen e të drejtës për të përfituar prej tij. Nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje, si dhe për të dënuarit për kryerjen e veprave penale... 81. ... Rezulton se kërkuesi nuk përmbush as kushtin e të mos qenit përsëritës për krime të kryera me dashje, që përbën kusht ndalues për të përfituar nga lirimi me kusht. Rezulton se kërkuesi G. Gj., me vendimin e datës 20.01.1997, të Gjykatës së Milanos, Itali (vendim që ka marrë formë të prerë në datën 16.03.1997), është dënuar me një vit e gjashtë muaj burgim dhe 500.000 lireta gjobë, për veprën penale ‘Falsifikimi i monedhave’, parashikuar nga neni 455 i Kodit Penal Italian, vepër kjo e parashikuar nga neni 183 i Kodit Penal Shqiptar. Po kështu, kërkuesi G. Gj. është dënuar dhe me vendimin nr. {***}, datë 21.12.1999, të Gjykatës së Krimeve të Rënda Milano, Itali (i cili ka marrë formë të prerë me vendimin e datës 02.02.2001, të Gjykatës së Apelit Milano), me burgim të përjetshëm dhe dënime të tjera plotësuese. Fakti që këto dënime janë bashkuar në një të vetëm, nuk eliminon ekzistencën e të dyjave dënimeve dhe as faktin që ai është përsëritës për krime të kryera me dashje. Gjykata e Lartë ka konkluduar se: [...]. Sa më sipër, Kolegji vlerëson se vendimmarrja e Gjykatës së Apelit është e arsyetuar referuar fakteve dhe rrethanave të çështjes, duke u zbatuar drejtë prej saj dispozitat penale materiale, neni 64 dhe neni 65 i Kodit Penal që rregullon institutin e lirimit me kusht në përgjithësi dhe për të dënuarin me burgim të përjetshëm, siç është kërkuesi G. Gj. në rastin konkret”.

42.5. Në konkluzion të të gjithë argumenteve të dhëna më lart, Kolegji vlerëson se moszbatimi nga ankuesi i parashikimeve të nenit 64, paragrafi 3 të Kodit Penal, vjen në kundërshtim me parashikimet ligjore të dispozitave që rregullojnë lirimin para kohe me kusht. Duke pranuar arsyetimin e përdorur edhe nga gjykatat më të larta, standardet e vendosura si kritere për lirimin para kohe me kusht për të dënuarit me burgim, logjikshëm duhet të aplikohen edhe si kriter për lirimin para kohe me kusht për të dënuarit me burgim të përjetshëm, mbi parimin se kemi të bëjmë me të njëjtin institut, pavarësisht ashpërsisë së dënimeve dhe se sa më i ashpër është dënimi aq më të forta janë kriteret për të përfituar nga ky institut që përfaqëson një alternativë të dënimit me burgim. Në këto kushte, Kolegji gjen me vend qëndrimin e mbajtur prej KLGj-së lidhur me konsiderimin si shkelje të ligjit mosmbajtjen në konsideratë të këtij kriteri.

- 43.** Ankuesi, lidhur me shkeljen e konstatuar nga ILD-ja për mosrespektimin e kushtit *jo më pak se 35 vjet burgim*, të parashikuar në nenin 65/3 të Kodit Penal, në kundërshtim me përcaktimet e Vendimit Unifikues nr. 4/2003, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, parashtron se ky vendim ka gjetur trajtim në përmbajtjen e arsyetimit të gjykatës, por rezulton se është i paaplikueshëm për rastin specifik të zgjidhur nga gjykata, për lirimin me kusht. Sipas ankuesit, rasti i trajtuar nga Gjykata e Lartë në vendimin unifikues lidhet me përfitimin që kërkonte i dënuari

nga modifikimi i normës penale për të cilën paraqitej i dënuar. Kurse në rastin e kërkesës së një të dënuari për lirim me kusht, sipas ankuesit, koncepti i aplikimit të normës penale më favorizuese ndryshon dhe nuk mund të diktohet nga ky vendim unifikues. Neni 65 i Kodit Penal, nuk është dispozitë e karakterit të ndonjë figure vepre penale, por që lidhet me të drejtën e të dënuarit për të kërkuar reduktimin e dënimit të caktuar nga gjykata. Ashpërsimi i kriterit kohor, nga 25 vjet në 35 vjet, për kohën që duhet të vuajë i dënuari për të realizuar të drejtën e paraqitjes së kërkesës, nuk lidhet me modifikimin e dispozitës penale, që rregullon Vendimi Unifikues nr. 4/2003.\

43.1. Në vlerësim të këtij pretendimi të ankuesit, Kolegji vëren se:

43.1.1. Neni 65, paragrafi 2, i Kodit Penal parashikon: *“2.Vetëm në raste të jashtëzakonshme i dënuari me burgim të përjetshëm mund të lirohet me kusht kur: Ka vuajtur jo më pak se tridhjetë e pesë vjet burgim dhe gjatë vuajtjes së dënimit ka mbajtur sjellje shembullore dhe çmohet se i është arritur qëllimit të dënimit për edukimin e tij”.*

43.1.2. Në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, ankuesi, pasi ka konstatuar faktin se i dënuari në datën e kërkesës për lirim me kusht nuk ka plotësuar kushtin ligjor prej 35 vjetësh, ka dhënë argumentin se *...ky ndryshim i normës materiale (nga 25 vjet në 35 vjet pas ndryshimit të Kodit Penal me ligjin nr. 36/2017), paraqitet me rrethana rënduese për të dënuarin dhe, në këtë rast, gjykata vlerëson të aplikojë përmbajtjen më favorizuese të normës materiale penale, që lidhet me të drejtat e të dënuarit në fazën e ekzekutimit të vendimit të dënimit dhe, më konkretisht, aplikimin e afatit 25 vjeçar, i cili për sa është parashtruar dhe argumentuar në datën e paraqitjes së kërkesës për lirim me kusht, rezulton jo vetëm që është përmbushur si kriter formal nga i dënuari, por edhe paraqitet i tejkualuar prej këtij të dënuari.*

43.1.3. Lidhur me këtë arsyetim të ankuesit në zbatimin e paragrafit të tretë të nenit 65 të Kodit Penal, Gjykata e Apelit Korçë ka konstatuar se *i dënuari nuk ka vuajtur më tepër se 35 vjet burgim dhe vetëm, për këtë arsye, kërkesa duhej të ishte rrëzuar, edhe pa i analizuar arsyet e tjera që kërkojnë nga dispozita, edhe pa u investuar në hetim, në marrje raportesh të I EVP apo të zyrës së Shërbimit të Provës.*

43.1.4. Ndërsa Këshilli i Lartë Gjyqësor, lidhur me këtë qëndrim të ankuesit, ka vlerësuar se: *“66.2. Magjistrati ka synuar të injorojë vendimin unifikues të KBGJL, {...}, (lidhur me interpretimin e nenit 3 të Kodit Penal, për rastet e debatueshme për fuqinë e ligjit penal në çështjet që ndodhen në fazën e ekzekutimit të dënimit penal), duke u referuar në dispozita ligjore, akte ndërkombëtare dhe jurisprudencë të Gjykatës Kushtetuese apo të GJEDNJ-së, jo adekuate për rastin në shqyrtim. [...] Nga llogaritja e masës së dënimit të kryer nga kërkuesi që rezulton 30 vjet, 7 muaj, 18 ditë burgim, pra më e ulët se sa 35 vjet burg që parashikon neni 65 i Kodit Penal, për të cilin vetë magjistrati pranon në vendim se kjo dispozitë e Kodit Penal, ndonëse është dispozitë materiale penale i shtrin efektet juridike në fazën e ekzekutimit të dënimit. E për rrjedhojë sipas praktikës Unifikuese të KBGJL-së, duhet të zbatohet parashikimi i ligjit aktual dhe jo i kohës kur është kryer vepra penale.[...] Për të mos e marrë në konsideratë këtë kusht pengues formal të shqyrtimit të*

kërkesës për lirimin e një të dënuari me burgim të përjetshëm, (sepse kërkuesi nuk kishte vuajtur 35 vjet burgim), magjistrati përsërit në mënyrë të panevojshme përmbajtjen dhe dinamikën e ndryshimeve të nenit 65 të Kodit Penal duke përshkruar, kështu disa herë në arsyetim, si ligjin nr. 36/2017, ashtu edhe këtë dispozitë, para e pas datës 21.05.2019 [...]”.

43.2. Në parashtrimet dhe konkluzionet përfundimtare të paraqitura në Kolegj, KLGj-ja, lidhur me këtë trajtim dhe interpretim që ankuesi i ka bërë Vendimit Unifikues nr. 4/2003, përsërit qëndrimin se ankuesi në arsyetimin e vendimit citon Vendimin Unifikues nr. 4/2003, por nuk e zbaton atë në zgjidhjen e çështjes. Në kundërshtim me parashikimet e nenit 3 dhe nenin 65/3 të Kodit Penal, si dhe Vendimit Unifikues nr. 4/2003, nga ana e ankuesit nuk është mbajtur në konsideratë plotësimi i kërkesës ligjore me natyrë objektive si koha e nevojshme e kaluar në vuajtje të dënimit me burgim, të parashikuar nga neni 65/3 i Kodit Penal, si dhe janë zbatuar gabim dispozitat të cilat lidhen me aplikimin e ligjit penal në kohë parashikuar nga neni 3 i Kodit Penal. Ligji penal favorizues i parashikuar nga neni 3 i Kodit Penal, sipas Vendimit Unifikues nr. 4/2003, nuk zbatohet në fazën e ekzekutimit të vendimit, pasi në këtë fazë gjejnë zbatim normat e ligjit procedural penal.

43.3. KLGj-ja ka parashtruar në Kolegj se pretendimi për shkelje të Vendimit Unifikues nr. 4/2003, të Gjykatës së Lartë, është referuar fillimisht nga Ministri i Drejtësisë, ndërsa është specifikuar edhe në Vendimin e ILD-së, për fillimin e hetimit disiplinor, si një nga shkaqet e fillimit të këtij hetimi. Kjo shkelje është në përmbajtjen e Raportit të Hetimit, si dhe në parashtrimet e ILD-së në seancë dëgjimore, në të kundërt të asaj që pretendon ankuesi që: *“Këshilli ka dalë jashtë objektit të procesit disiplinor, pasi për asnjë rast nga ana e ILD-së nuk është relatuar shkelje nga ky këndvështrim trajtues, si kjo që ka trajtuar Këshilli”.*

43.4. Përveç sa më sipër, Kolegji, gjithashtu, konstaton se Gjykata e Lartë, në Vendimin nr. {***} i Vendimit {***}, datë 14.06.2022, që i përket çështjes me kërkues G. Gj., ka mbajtur qëndrim lidhur me kriterin objektiv që duhej plotësuar si një parakusht për aplikimin e lirit para kohe me kusht, duke arsyetuar se: *“Rezulton se gjykata e shkallës së parë, në fakt, ka bërë një përzjerje të ligjit që rregullon lirimin me kusht, duke zbatuar herë ligjin e mëparshëm dhe herë ligjin në fuqi në kohën e shqyrtimit të kërkesës. Në lidhje me kohën e dënimit të vuajtur, gjykata e shkallës së parë i është referuar ligjit të kohës, kur është kryer vepra penale, ndërsa në lidhje me kriteret ndaluese i referohet ligjit të kohës, kur është duke u shqyrtuar kërkesa. [...] Kolegji vlerëson se në pretendimin për të përfutur lirimin me kusht, nuk gjen zbatim parimi i ligjit penal favorizues, parashikuar nga neni 3/3 i Kodit Penal. Ky parim gjen zbatim për ligjin penal material që zbaton gjykata e themelit, kur gjykon çështjen penale në ngarkim të të pandehurit. Në kushtet kur kërkuesi pretendon lirim me kusht, gjykata do të zbatojë ligjin që është në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës, duke zbatuar kushtet dhe kriteret që kërkon dispozita penale konkrete. Kolegji vlerëson se është jashtë logjikës juridike që për lirimin me kusht të zbatohet ligji i kohës, kur është kryer vepra penale, pasi instituti i lirit me kusht nuk ka lidhje me kohën e kryerjes së veprës penale”.*

43.5. Në vështrim të sa më sipër, Kolegji konstaton se të dy gjykatat më të larta kanë gjetur si zbatim të gabuar të ligjit aplikimin e nenit 65 të Kodit Penal para ndryshimeve të vitit 2017, nga ana e ankuesit. Ndonëse në vendimin e Gjykatës së Lartë nuk referohet literalisht se qëndrimi i ankuesit vjen në kundërshtim me Vendimin Unifikues nr. 4/2003, ai pranon se mënyra se si ankuesi e ka zbatuar ligjin është jashtë logjikës ligjore, duke konsideruar të drejtë qëndrimin që është mbajtur nga Gjykata e Apelit Korçë, lidhur me këtë çështje.

43.6. Për sa më sipër, Kolegji, referuar edhe pretendimit të ankuesit se KLGj-ja nuk mund të marrë një qëndrim lidhur me këtë çështje sepse kjo i përket Gjykatës së Lartë, si një gjykatë ligji, çmon se pavarësisht mospasjes së një qëndrimi të qartë nga Gjykata e Lartë, lidhur me relevancën e Vendimit Unifikues nr. 4/2003, në zgjidhjen e çështjes, fakti që kjo gjykatë pranon si të padrejtë trajtimin e veprimit në kohë të nenit 65 të Kodit Penal prej ankuesit, e ezauron dhe i jep përgjigje çështjes që duhet të zgjidhë Kolegji, lidhur me shkeljen e ligjit të kryer prej ankuesit. Në këto kushte, Kolegji arrin në konkluzionin se qëndrimi i mbajtur prej KLGj-së, se ankuesi ka kryer shkelje të ligjit, lidhur me zbatimin e nenit 65 të Kodit Penal para ndryshimeve të vitit 2017, ndërsa duhet të zbatonte normën që ishte në fuqi në kohën e gjykimit të çështjes, është i drejtë dhe pretendimi i ankuesit i pabazuar.

43.7. Në kuadër të shqyrtimit të pretendimeve të mësipërme të ankuesit për interpretimin e nenit 65/3 të Kodit Penal, Kolegji gjen me vend të shprehet edhe lidhur me pretendimin e ankuesit se qëndrimi i KLGj-së, lidhur me jurisprudencën e referuar prej tij në arsyetimin e vendimit, nuk është në kompetencën vlerësuese të KLGj-së.

43.7.1. Kolegji vëren se KLGJ-ja, duke iu referuar argumentimit dhe jurisprudencës së përdorur nga ankuesi në vendimin e tij, si dhe qëndrimin të mbajtur nga Gjykata e Apelit Korçë, ka konkluduar se: *“66.10 Me qëllim që të justifikojë masën e paarrirë të dënimit të vuajtur nga kërkuesi G. Gj., magjistrati me një praktikë të diskutueshme të GJEDNJ-së, në arsyetimin e vendimit shprehet se: “Në rastin konkret, Kodi Penal apo K.Pr.Penale, në raport me KEDNJ-në dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së, në hierarkinë e akteve normative qëndron më poshtë. Prandaj, në rastet e ndryshimit të një norme materiale që lidhet me fazën e ekzekutimit të dënimit me burgim, Gjykata çmon t’i referohet drejtpërsëdrejti standardeve të vendosura në çështjen Del Ria Prada kundër Spanjës [GC] - 42750/09, duke e zgjeruar edhe më tej interpretimin si më sipër të Gjykatës Kushtetuese, për hierarkinë e akteve ligjore e nënligjore, sepse, pas përfshirjes së dispozitave të Konventës, shton në këto raporte edhe jurisprudencën e GJEDNJ-së, të cilën e vendos në krye të hierarkisë së akteve ligjore, që duhet të zbatohet në zgjidhjen e rastit në gjykim. 66.11. Madje për të qenë më bindës, në arsyetim (nga faqja 11 deri në faqen 15) përshkruhet fjalë për fjalë vendimi i datës 21.10.2013 të GJEDNJ-së në çështjen Del Ria Prada kundër Spanjës. Por kjo mënyrë arsyetimi, jo vetëm është e gabuar e në kundërshtim me rregullat e arsyetimit ligjor, por edhe sjell për këdo që njihet me këtë vendim, efektin e kundërt me atë të dëshiruar dhe të konkluduar nga magjistrati në pranimin e kërkesës për lirimin me kusht të të dënuarit G. Gj.”.*

43.7.2. Kolegji konstaton nga vendimi i GJEDNJ-së *Del Ria Prada kundër Spanjës [GC]* -

42750/09, i referuar nga ankuesi, se në pjesën hyrëse të tij, në përshkrimin e dënimit të dhënë ndaj kërkueses është përcaktuar se *Audiencia Nacional (Gjykata me juridiksion mbi çështjet terroriste) e fiksoi maksimumin e dënimit që kërkuesja duhet të vuante për sa u përkiste të gjitha dënimeve të saj me burg të kombinuara në tridhjetë vjet dhe se kërkuesja ka bërë kërkesë për lirim pas përfundimit të dënimit të dhënë. Nisur nga këto fakte, Kolegji çmon se çdo analogji e përdorur nga ankuesi në argumentimin e vendimit gjyqësor, më vendimin e GJEDNJ-së, është e papërshtatshme për shkak se dy çështjet të cilat ankimesi kërkon në mënyrë të sforcuar t'i trajtojë si të ngjashme kanë si dallim kryesor llojin e dënimit, që në rastin e kërkueses në çështjen *Del Ria Prada kundër Spanjës* ka qenë i përcaktuar në tridhjetë vjet dhe kërkesa e saj për lirim pas kryerjes së dënimit nuk konsiderohet kërkesë për lirim me kusht, ndërsa në rastin e kërkuesit G. Gj., dënimi ka qenë me burgim të përjetshëm. Për rrjedhojë, Kolegji e gjen të drejtë qëndrimin e KLGj-së, që në trajtimin e që i ka bërë shkeljes së ankuesit në drejtim të mosrespektimit të kërkesave të nenit 65/3 të Kodit Penal, ka konstatuar dhe referimin në jurisprudencë të GJEDNJ-së jo adekuate, duke shtrembëruar tërësisht faktet e ndryshme me rastin e *Del Ria Prada*.*

44. Sipas ankuesit Vendimi Unifikues nr. 2/2015, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nuk gjen zbatim të detyrueshëm në çështjen objekt kërkimi për fillimin e procedimit disiplinor, pasi kjo vendimmarrje e karakterit unifikues i referohet konceptit trajtues dhe zbatues të nenit 64 të Kodit Penal dhe për asnjë rrethanë të konceptit trajtues dhe zbatues të nenit 65 të po këtij Kodi, lidhur me rastin e jashtëzakonshëm.

44.1. Ankuesi ka parashtruar në Kolegji se Këshilli i Lartë Gjyqësor në vendimin e tij, si dhe ILD, duhet të specifikonin në mënyrë të qartë dhe pa shmangie se për cilat arsye të trajtimit teorik dhe praktik, Vendimi Unifikues nr. 2/2015, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, gjendet i aplikueshëm edhe për rastin që sanksionon neni 65 i Kodit Penal, ndërkohë që për asnjë rast apo rrethanë në përmbajtjen thjesht formale të vendimit unifikues, neni 65 jo vetëm që nuk është përmendur, por as që është referuar dhe jo më të jetë argumentuar ndonjë qëndrim lidhës midis tij dhe situatës së unifikuar që rrjedh nga mënyra e zbatimit të nenit 64 të Kodit Penal. Vendimi Unifikues nr. 2/2015 është praktikë e detyrueshme gjyqësore vetëm për rastet e lirimit me kusht të parashikuara nga neni 64 i Kodit Penal, por nuk është i vlefshëm për këtë lloj praktike në lidhje me nenin 65 të po këtij Kodi. “Arsyet e veçanta”, të kërkuara nga neni 64 i Kodit Penal dhe të trajtuara specifikisht nga Vendimi Unifikues nr. 2/2015, nuk kanë lidhje organike dhe ligjore me “Rastin e jashtëzakonshëm”, të kërkuar nga neni 65 i Kodit Penal.

44.2. Në shqyrtim të këtij pretendimi të ankuesit, Kolegji konstaton se në vendimin nr. {***}, datë 14.02.2019, ankuesi ka vlerësuar se rasti i të dënuarit G. Gj. paraqet specifika të “rastit të jashtëzakonshëm”, të kërkuar nga neni 65 i Kodit Penal, bazuar në Raportin e drejtorit të I EVP-së Drenovë, si dhe në raportin e vlerësimit të të dënuarit nga zyra vendore e Shërbimit të Provës, Korçë të testuar nga gjykata në çdo konkluzion në mënyrë të thelluar. Sipas këtyre raporteve, sjellja e të dënuarit në raport me rregullat e burgut dhe të dënuarit e tjerë, pjesëmarrja në aktivitete,

edukimi, marrëdhëniet me familjen, projektet për të ardhmen, kanë sjellë në konkluzionin se gjatë kohës së vuajtjes së dënimit i dënuari ka shprehur në mënyrë të qartë rehabilitimin dhe se perspektiva e riintegritit të tij në shoqëri është e mundshme. Në përfundim, gjykata ka konkluduar se rezultoni e provuar në kuadër të shqyrtimit gjyqësor se i dënuari G. Gj. plotëson kërkesat substanciale të ligjit për t'u cilësuar si i rehabilituar, paraqitet me normalizim të plotë të marrëdhënieve me trashëgimtarët e viktimave nga vepra penale dhe ka provuar me veprime konkrete qëndrimin e tij shembullor, duke argumentuar dhe provuar veprime konkrete të ndërmarra prej tij për të arritur rehabilitimin dhe riintegrimin.

44.3. Lidhur me trajtimin që ankuesi i ka bërë *rasteve të jashtëzakonshme* të parashikuara në nenin 65 të Kodit Penal, Gjykata e Apelit Korçë shprehet se: *“Ndryshe nga sa udhëzon Gjykata e Lartë në këtë vendim unifikues (Vendimi i KBGjL nr. 2/2015), në rastin konkret nuk janë mbajtur parasysh natyra e veprave penale të kryera nga i dënuari, kryerja e disa veprave penale, rrezikshmëria shoqërore tepër e lartë e veprave dhe autorit të tyre të vlerësuara këto nga gjykatat që kanë dhënë vendimet duke caktuar ndaj tij dënimin më të rëndë të mundshëm, atë me burgim të përjetshëm. Gjithashtu, nga dosja rezultoi se nuk ka pasur programe rehabilitimi për të dënuarin. Gjykata e Apelit vlerëson se ...nuk ka asnjë provë ku të mbështetet sjellja shembullore e të dënuarit, përveç citimit të kësaj shprehjeje në raportin e drejtorit të I EVP Drenovë, në një kohë kur i dënuari ka qenë në I EVP për një periudhë tepër të shkurtër, ai është transferuar në këtë I EVP-në datën 12.07.2018 dhe vetëm pas njëmbëdhjetë ditësh në këtë institucion ka bërë kërkesë për lirim me kusht...Në vlerësimet periodike të sjelljes së të dënuarit në I EVP-të e Shqipërisë në asnjë rast nuk është pasqyruar si shembullore”*.

44.4. Gjykata e Apelit Korçë mban qëndrimin se pavarësisht se në vendimin unifikues nuk jepet kuptimi i shprehjes *“i jashtëzakonshëm”*, është e qartë se në këtë rast duhet të plotësohen kërkesa të një niveli shumë më të lartë se sa për plotësimin e kriterit *“arsye e veçantë”*.

44.5. Këshilli i Lartë Gjyqësor, lidhur me sa më sipër, shprehet se: *“67. Këshilli sjell në vëmendje se të gjitha rrethanat e parashikuara nga ligji në paragrafin e dytë të nenit 65 të Kodit Penal, duhet të përmbushen në mënyrë kumulative, jo vetëm sepse ligjvënësi ka përdorur lidhësen bashkuese ‘dhe’, por edhe sepse plotësimi i të tre kushteve (vuajtja jo më pak se 35 vjet, sjellja shembullore gjatë gjithë kësaj periudhë, arritja e qëllimit të dënimit-rehabilitimi dhe edukimin e tij-riintegrimi) do të justifikonin edhe ekzistencën e rastit të jashtëzakonshëm që kërkohet për mundësinë e lirim të të dënuarit me burgim të përjetshëm. [...] Nga verifikimi i procedurës gjyqësore të ndjekur nga magjistrati, rezultoi haptazi se jo vetëm nuk ka mbajtur në konsideratë këto kërkesa të ligjës, por ka vepruar në kundërshtim të hapur edhe me vendimin unifikues të KBGJL nr. 2/2015. Verifikimi i këtyre kushteve të nenit 65/2 të Kodit Penal, nuk mund të kuptohet pa verifikuar në detaje e jo vetëm formalisht natyrën e veprës penale që ka kryer i dënuari. Rehabilitimi i tij, nuk lidhet vetëm me mungesën e masave disiplinore për periudhën disa javore të vuajtjes së dënimit në Burgun e Drenovës Korçë, apo atë disavejeçare në Shqipëri. Sipas Vendimit Unifikues të KBGJL nr. 2/2015, (por edhe jurisprudencës së GJEDNJ-së dhe një sërë*

aktesh ndërkombëtare që trajtojnë këtë problematikë), gjatë shqyrtimit të kërkesës për lirimin me kusht të një të dënuari, duhen mbajtur në konsideratë disa rrethana që mund të verifikohen vetëm nëse gjykata administron dhe analizon pjesën arsyetuese të vendimit të dënimit, prej së cilës jo vetëm do të marrë dijeni për natyrën e veprës penale të kryer, por edhe për rrethanat konkrete të kryerjes së saj, për rolin e të dënuarit në kryerjen e veprës, për motivet e qëllimin e kryerjes së saj etj. Mbi bazën e shqyrtimit të këtyre rrethanave në raport me sjelljen e të dënuarit gjatë gjithë kohës së vuajtjes së dënimit, mund të arrihet në një përfundim të drejtë nëse i dënuari është rehabilituar dhe se lrimi i tij i mundshëm, nuk do të përbëjë, me siguri maksimale, rrezik për shoqërinë. [...] 68.3. Në lidhje me pretendimet e magistratit se Vendimi Unifikues nr. 2/2015, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nuk gjen zbatim të detyrueshëm në çështjen objekt kërkimi për fillimin e procedimit disiplinor pasi për çdo rast të vlerësimit dhe unifikimit të praktikës gjyqësore, kjo vendimmarrje e karakterit unifikues, i referohet konceptit trajtues dhe zbatues të nenit 64 të Kodit Penal dhe për asnjë rrethanë konceptit trajtues dhe zbatues të nenit 65 të po këtij Kodi, si dhe pretendimit se ‘Arsyet e veçanta’ të kërkuara nga neni 64 i Kodit Penal dhe të trajtuara specifikisht nga Vendimi Unifikues nr. 2/2015, i KBGJL, nuk kanë lidhje organike dhe ligjore me ‘Rastin e jashtëzakonshëm’, të kërkuar nga neni 65 i Kodit Penal, Këshilli vlerëson se Vendimi Unifikues nr. 2/2015, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, që i referohet konceptit trajtues dhe zbatues të nenit 64 të Kodit Penal, duhet të mbahet në konsideratë edhe gjatë trajtimit dhe zbatimit të nenit 65 të Kodit Penal, për sa kohë këto dy nene së bashku rregullojnë të njëjtin institut të së drejtës materiale penale, ‘lirimin me kusht’. Për më tepër, vetë magistrati në vendimin nr. {***}, datë 14.02.2019, i është referuar këtij vendimi unifikues gjatë analizimit dhe arsyetimit të ‘arsyeve të veçanta’, ‘rastit të jashtëzakonshëm’ etj.”.

44.6. Lidhur me qëndrimin e mbajtur nga ankuesi se nenet 64 dhe 65 të Kodit Penal janë autonome dhe se neni 64 nuk zbatohet për rastet e situatave me të dënuar të përjetshëm, KLGj-ja ka prapësuar në Kolegj se ky qëndrim është i pabazuar, sipas vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë, e cila shprehimisht evidenton se: “...Gjykata e Apelit arrin në përfundimin se në rastin në gjykim nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative të gjitha kërkesat e neneve 64 e 65 të Kodit Penal, për lirimin me kusht të të dënuarit me burgim të përjetshëm. Duke qenë se nuk plotësohen këto kushte ai nuk duhej të përfitonte nga lrimi me kusht. Për këto shkaqe, vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë që pranon lirimin me kusht, është i gabuar dhe duhet të ndryshohet”.

44.7. Për sa i përket interpretimit të “arsyeve të veçanta” dhe “rasteve të jashtëzakonshme”, Gjykata e Lartë, në vendimin nr. nr. {***} i Vendimit {***}, datë 14.06.2022, ka mbajtur qëndrimin se: “[...] Kolegji thekson se rastet e jashtëzakonshme të kërkuara nga ligjvënësi për lirimin me kusht për të dënuarin me burgim të përjetshëm nuk mund të barazohen me arsyet e veçanta që kërkohen për lirimin me kusht për të dënuarin me burgim, të interpretuara në vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara nr. 2, datë 25.05.2015 [...]. Për të dënuarin me burgim të përjetshëm ligjvënësi kërkon ekzistencën e rasteve të jashtëzakonshme të cilat në kuptim të ligjit janë ato raste të rralla dhe që çmohen prej gjykatës, si jo vetëm të jashtëzakonshme, por edhe që për rëndësinë që kanë përligjin lirimin me kusht të të dënuarit me burgim të përjetshëm, në rast se

ai plotëson edhe kushtet e tjera që kërkon dispozita; ka vuajtur jo më pak se tridhjetë e pesë vjet burgim dhe gjatë vuajtjes së dënimit ka mbajtur sjellje shembullore dhe çmohet se i është arritur qëllimit të dënimit për edukimin e tij. [...] Gjithsesi, Kolegji çmon se rastet e jashtëzakonshme nuk përfshihen tek arsyet e veçanta dhe ato duhet të analizohen dhe argumentohen prej gjykatës që vendos në lidhje me lirimin me kusht. [...] Sa më sipër, Kolegji vlerëson se vendimmarrja e Gjykatës së Apelit është e arsyetuar, referuar fakteve dhe rrethanave të çështjes, duke u zbatuar drejt prej saj dispozitat penale materiale, neni 64 dhe neni 65 i Kodit Penal që rregullon institutin e lirimit me kusht në përgjithësi dhe për të dënuarin me burgim të përjetshëm, siç është kërkuesi G. Gj., në rastin konkret. Kolegji vlerëson se pavarësisht se Gjykata e Apelit ka vlerësuar mungesën e kushteve objektive të kërkuesit për të përfutuar nga lirimi me kusht, kjo gjykatë, gjithashtu, ka analizuar edhe mbi ekzistencën ose jo të rrethanave të jashtëzakonshme, të cilat janë marrë në vlerësim dhe janë interpretuar drejt prej Gjykatës së Apelit, në lidhje me kërkesën e kërkuesit G. Gj., për lirim me kusht”.

44.8. Për sa më lart, Kolegji konstaton se Gjykata e Lartë, lidhur me interpretimin e “rasteve të jashtëzakonshme” në raport me “arsye të veçanta”, si dhe me zbatimin e Vendimit Unifikues nr. 2/2015, të KBGJL-së, në rastin konkret, mban një qëndrim të ndryshëm nga Gjykata e Apelit Korçë. Por, pavarësisht këtij qëndrimi, Gjykata e Lartë është shprehur se: *“Kolegji vlerëson se pavarësisht se Gjykata e Apelit ka vlerësuar mungesën e kushteve objektive të kërkuesit për të përfutuar nga lirimi me kusht, kjo gjykatë, gjithashtu, ka analizuar edhe mbi ekzistencën ose jo të rrethanave të jashtëzakonshme, të cilat janë marrë në vlerësim dhe janë interpretuar drejtë prej Gjykatës së Apelit, në lidhje me kërkesën e kërkuesit G. Gj., për lirim me kusht”.*

- Në përfundim, lidhur me pretendimin e ankuesit se Vendimi Unifikues nr. 2/2015, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nuk gjen zbatim të detyrueshëm në çështjen objekt kërkimi për fillimin e procedimit disiplinor, Kolegji vlerëson se pavarësisht se nuk ka një qëndrim të qartë lidhur me këtë çështje në vendimin e Gjykatës së Lartë, mbetet i konfirmuar qëndrimi i KLGj-së mbi vlerësimin e gabuar të rrethanave të rastit konkret si “rast i jashtëzakonshëm” prej ankuesit. Kolegji, vlerëson në të njëjtën mënyrë se analiza dhe pesha që ankuesi u ka dhënë rrethanave të rastit konkret nuk kanë qenë të duhurat dhe se ai ka vendosur kritere të shproporcionuara për përcaktimin e rastit të jashtëzakonshëm, në kundërshtim me frymën dhe qëllimin e dispozitës. Rrethanat e përzgjedhura dhe të trajtuara nga ankuesi për të argumentuar plotësimin prej të dënuarit të kërkesave të paragrafit të dytë të nenit 65 të Kodit Penal, rezultojnë se jo vetëm që nuk mund të vlerësohen si “të jashtëzakonshme”, por për nga rëndësia e tyre nuk mund të kategorizohen as si “arsye të veçanta”, duke mos justifikuar konkluzionin e dhënë nga ankuesi në vendim se ka pasur arsye të jashtëzakonshme që bënin të mundur pranimin e kërkesës së të dënuarit me burgim të përjetshëm.

45. Sipas ankuesit, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në pikën 67.5 të vendimit të tij, ka transformuar tërësisht faktin juridik të kualifikimit të veprës penale për të cilën ishte dënuar kërkuesi i lirimit me kusht, duke ndryshuar kualifikimin ligjor të figurës së veprës penale, në drejtim të zbatimit të kërkesave të nenit 65, paragrafi i tretë, të Kodit Penal.

45.1. Në vendimin e dhënë prej tij, ankuesi ka argumentuar se: “...gjykata konstaton se si në rastin e kualifikimit të veprës penale, nga përmbajtja sanksionuese e nenit 78 të Kodit Penal, të para ndryshimit të tij me ligjin nr. 144/2013, ashtu edhe pas këtij ndryshimi, ku rrethana cilësuese e vrasjes për gjakmarrje është hequr nga përmbajtja e paragrafit të dytë të nenit 78 dhe është rikualifikuar si një normë e re penale, e formuluar nga sanksioni i nenit 78/a të Kodit Penal, veprimet e anës objektive të të dënuarit, nuk janë kualifikuar për asnjë rast si vrasje për gjakmarrje”.

45.2. Gjykata e Apelit Korçë, lidhur me këtë arsytim të vendimit të dhënë nga ankuesi, ka konstatuar se: “...gjykata ka kontradiktë në arsyetimin e saj. Kur është fjala për kohën e vuajtjes së dënimit të mjaftueshme për të bërë kërkesë për lirim me kusht, sipas nenit 65 të Kodit Penal, gjykata i referohet Kodit Penal të kohës kur është kryer vepra penale. Ndërsa, kur është fjala për kritere ndaluese, ekzistenca e të cilave nuk e lejon lirimin me kusht, për disa vepra penale të parashikuara në paragrafin e tretë të nenit 65 të Kodit Penal, gjykata i referohet Kodit Penal aktual, pra, të kohës kur është shqyrtuar kërkesa për lirim me kusht. Gjykata është shprehur ‘I dënuari i nënshtrohet zbatimit të ligjit material penal në kohë dhe në hapësirë, duke mos rezultuar rast përjashtimor i kërkuar nga neni 78/a i Kodit Penal për paraqitjen e kërkesës së këtij lloji për lirim me kusht’”.

45.3. Këtë argumentim në vendim të ankuesit e ka konstatuar si shkelje edhe ILD-ja që, referuar vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë, ka parashtruar para Këshillit të Lartë Gjyqësor se: “Në të njëjtën kohë, magjistrati, subjekt hetimi disiplinor ka qenë kontradiktor në referimin e ligjit të zbatueshëm atë të kohës të kryerjes së veprave penale, pasi, kur analizon kriteret ndaluese për lirimin me kusht që parashikon neni 65 i Kodit Penal, për dy kushte të parashikuara nga e njëjta dispozitë, njëherë zbaton ligjin penal të kohës kur është kryer vepra penale dhe për kushtin tjetër zbatohet ligji penal i kohës, kur paraqitet dhe shqyrtohet kërkesa për lirim me kusht”.

45.4. Në prapësimet e paraqitura, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka shprehur qëndrimin se në përmbajtje të vendimit të tij, rendit si shkelje të ligjit në veprimtarinë e ankuesit në vendimin nr. {***}, datë 14.02.2019, vetëm shkeljet e evidentuara nga Gjykata e Apelit Korçë në vendimin nr. {***}, datë 26.06.2019.

45.5. Por, konstatohet se në paragrafin 67.5 të Vendimit, KLGJ-ja pasi është shprehur se “nuk rezulton që (magjistrati) as të ketë verifikuar përmbajtjen e pjesës arsyetuese të vendimit të dënimit të dhënë nga gjykata e shtetit dënues dhe as të ketë bërë analizën e ngjarjes së ndodhur në Itali, me pasojë vrasjen e dy personave..” vazhdon duke konkluduar se: “ të cilat mund të kualifikonin veprën si ‘vrasje për gjakmarrje’ dhe rrjedhimisht të përjashtoj nga mundësia për lirim me kusht sipas parashikimeve të nenit 65/3 të K.Penal, duke dalë jashtë objektit të gjykimit administrativ.”

45.6. Pavarësisht se në trajtimin e kësaj çështjeje duket se KLGJ-ja ka marrë attribute të një gjykate dhe ka bërë vlerësime mbi supozime për kualifikimin e mundshëm të rrethanave të ngjarjes si një

vepër tjetër penale, e ndryshme nga ajo që ka njohur Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. {***} akti, datë 10.03.2014, Kolegji çmon se ky konstatim i Këshillit nuk ka qenë përcaktues në marrjen e vendimit të tij, por ka shërbyer për të demonstruar konfuzitetin e vetë ankuesit në arsyetim, i cili brenda të njëjtin vendim mban dy qëndrime të ndryshme në raport me konsiderimin ose jo të nenit 65 të Kodit Penal, në fuqi në kohën e gjykimit të çështjes. Nga kjo pikëpamje, Kolegji e gjen të drejtë konkluzionin e KLGj-së se ankuesi ka pranuar zbatimin në kohë në mënyra të ndryshme për të njëjtën dispozitë penale, brenda arsyetimit të zgjidhjes së çështjes. Shpjegimet që ankuesi jep për të përligjur këtë dyzim, nuk e bindin Kolegjin dhe mbeten konfuze e të pakuptimta, siç mbetet e pakuptimtë edhe nevoja e pretenduar e ankuesit për të plotësuar arsyetimin e vendimit të tij me argumentet e mësipërme. Për pasojë, Kolegji e gjen në thelb të padrejtë pretendimin e tij lidhur me këtë qëndrim të Këshillit.

46. Kolegji ka marrë në shqyrtim edhe pretendimin e ankuesit se KLGj-ja ka marrë atributet e një gjykate ligji duke cenuar parimin e pavarësisë së gjyqësorit dhe se shkeljet e paraqitura në vendimin e KLGj-së, në lidhje me çështjen penale të gjykuar prej tij, kanë të bëjnë me bindjen e brendshme të gjyqtarit.

46.1. Në vështrim të sa është argumentuar më sipër, Kolegji çmon se këto pretendime të ankuesit janë të pabazuara. Këshilli i Lartë Gjyqësor në vendimin e tij ka konstatuar vetëm ato shkelje të ankuesit, të evidentuara nga Gjykata e Apelit Korçë, që kanë të bëjnë me zbatimin e gabuar të legjislacionit në fuqi, si dhe për referencat jo të drejta në jurisprudencën e GjK-së dhe të GJEDNJ-së. Në këtë aspekt, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në arsyetimin e dhënë në Vendimin nr. 633, nuk ka është shprehur për mënyrën se si duhet të zgjidhte çështjen gjyqtari, por për qëndrimin haptazi në kundërshtim me ligjin, në arsyetimin e vendimit të nxjerrë prej tij.

46.2. Edhe KLGj-ja, në lidhje me këtë pretendim të përsëritur të ankuesit gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegji, është shprehur se në rastin objekt shqyrtimi është pikërisht gjykata më e lartë në nivel hierarkik ajo e cila shprehet se magjistrati nuk ka zbatuar apo ka vepruar në kundërshtim me vendimin unifikues. Vetë vendimi i gjykatës më të lartë është i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, referuar nenit 462, pika 3, shkronja “b” të Kodit të Procedurës Penale. Ky vendim është i padiskutueshëm në raport me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, kjo edhe për shkak të qenies gjykatë hierarkike më e lartë, kjo e fundit dhe kontrollore e vendimeve të dhëna nga gjykata më e ulët.

46.3. Lidhur me respektimin e bindjes së brendshme të gjyqtarit, Kolegji nënvizon sërish qëndrimin e mbajtur prej tij në Vendimin nr. 1, datë 30.05.2021, se: *“13.4.13² Ndërsa sa i përket pretendimit të magjistratit se ushtrimi i ankimit lidhet me bindjen e brendshme të tij, Kolegji vlerëson se koncepti i ‘bindjes së brendshme’ të magjistratëve është i lidhur vetëm me interpretimin e ligjit në kontekstin e fakteve dhe provave të një çështjeje të caktuar. Magjistrati mban përgjegjësi disiplinore për mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, për sa kohë që nga rrethanat*

² Vendimi nr. 1, datë 30.05.2022, i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

objektive dhe subjektive, rezulton se veprimet e tij mund të kenë qenë të qëllimshme dhe në kundërshtim të hapur dhe flagrant me ligjin apo me praktikat unifikuese të gjykatave më të larta. Në çdo rast, bindja e brendshme duhet të jetë në përputhje me ligjin, me analizën e fakteve dhe provave në brendësi të çështjes, për ta kualifikuar atë sipas ligjit [...]”.

47. Ankuesi pretendon se KLGj-ja, ndonëse e mbështet vendimmarrjen në nenin 137 të Kushtetutës, nuk ka bërë të qartë në përmbajtjen e vendimit nëse veprimtaria gjyqësore e tij referon në drejtim të interesit vetjak, keqbesimit apo të dy këtyre situatave përjashtimore nga imuniteti që gëzon gjyqtari për mendimet e shprehura në marrjen e një vendimi gjyqësor.

47.1. Ankuesi pretendon se nuk ka pasur mundësi të kuptojë gjatë fazës së hetimit disiplinor, ashtu dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, se në cilën nga këto drejtime përjashtimore të sanksionuara nga neni 137 i Kushtetutës, veprimtaria e tij gjyqësore është specifikuar ose jo si e tillë, që të referojë në këto drejtime, si dhe asnjë provë që të mbështesë ato për t’i debatuar, në respektim të parimit të kontradiktoritetit dhe drejtësisë së hapur. Ankuesi pretendon se nuk ka pasur të artikuluar asnjë rrethanë shkeljeje që të lidhet në mënyrë të shprehur me qëllimin e tij për të dhënë një vendim me keqbesim apo për interes vetjak.

47.2. Në shqyrtim të këtij pretendimi, Kolegji konstaton se në përmbajtjen e vendimit të KLGj-së nuk përmendet asnjë qëndrim i Këshillit, në drejtim të argumentimit të vendimmarrjes së ankuesit, si pasojë e një interesi vetjak ose keqbesimi, i bazuar në parashikimet e nenit 137 të Kushtetutës. I vetmi qëndrim që ka mbajtur KLGj-ja ka qenë në drejtim të argumentimit se shkeljet disiplinore të ankuesit janë kryer me dashje direkte. Pavarësisht, Kolegji gjen me vend të arsyetojë se garancitë e vendosura nga neni 137 i Kushtetutës, sipas vlerësimit të Kolegjit, i referohen imunitetit nga ushtrimi i ndjekjes penale ndaj gjyqtarëve për shkak të vendimeve të tyre, përveç se kur provohen elementët e parashikuar në këtë dispozitë. Fakti që në vendimin e KLGJ-së nuk ka asnjë konkluzion, lidhur me qëllimin apo interesin vetjak që ka shoqëruar ankuesin në marrjen e vendimit, e përjashton atë nga ushtrimi i ndjekjes penale, por jo nga ushtrimi i kontrollit administrativ dhe vënia para përgjegjësisë disiplinore, kur provohen shkelje të ligjit nga ana e magjistratit.

48. Në përfundim, Kolegji, bazuar në të gjitha konkluzionet e arritura pas analizës përkatëse, çmon se është i drejtë qëndrimi i KLGj-së, për sa ka konkluduar se: (i) nga ana e magjistratit janë ndërmarrë veprime/mosveprime, të cilat kanë të bëjnë me mosrespektim të rëndë dhe të vazhduar të legjislacionit material dhe procedural penal, duke mos respektuar parashikimet e neneve 3, 64 dhe 65 të Kodit Penal, si dhe parashikimet e vendimeve Nr. 4/2003 dhe Nr. 2/2015, të Kolegjeve të Bashkuara, të Gjykatës së Lartë; (ii) nuk janë respektuar dispozitat penale me karakter urdhërues, të cilat parashikojnë kritere me karakter objektiv, ndalues dhe me një përmbajtje të drejtpërdrejtë dhe lehtësisht të kuptueshme, ku përvoja e gjatë profesionale në detyrë e magjistratit e lejon të interpretojë dhe zbatojë drejt këto dispozita; (iii) gjatë dhënies së vendimit nr. {***}, datë 14.02.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, arsyetimi i bërë nga ana e magjistratit nuk është bërë në përputhje me provat e administruara në gjykim dhe në përputhje me faktet dhe

rrethanat që janë provuar gjatë procesit gjyqësor, si dhe faktet dhe rrethanat janë parashtruar dukshëm në mënyrë të shtrembëruar dhe vetëm për t'ju përshtatur plotësisht të kërkesave formale (me natyrë objektive), si dhe atyre me natyrë subjektive të nenit 64 dhe nenit 65 të Kodit Penal; (iv) nga ana e magjistratit nuk është mbajtur në konsideratë, krahas jurisprudencës së Gjykatës së Lartë, në lidhje me këtë institut të së drejtës penale, edhe vetë praktika e tij e ndjekur gjatë trajtimit të kërkesave me objekt “Lirim me kusht”; (v) këto veprime/mosveprime të tij janë kryer në mënyrë drejtpërdrejtë, të vazhduar, të vullnetshme dhe të pajustificuar brenda të njëjtit proces gjyqësor.

49. Veprimet/mosveprimet e ankuesit për vetë natyrën dhe pasojat që kanë sjellë, janë konsideruar shkelje shumë të rënda, në analizën që KLGj-ja ka bërë mbështetur në kriteret e nenit 115, pika 1 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
50. Në vazhdim, Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, ka analizuar nëse shkeljet e evidentuara të magjistratit përbëjnë *shkelje të rënda profesionale që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit*, duke konkluduar se: “74.9. Për sa më sipër, nga analiza ligjore e fakteve të konstatuara, duke mbajtur në konsideratë: (i) natyrën e shkeljes disiplinore të parashikuar neni 102, pika 2, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; (ii) rrethanat e shkeljes së kryer të cilat kanë të bëjnë me mosrespektim të rëndë dhe të vazhduar të legjislacionit material dhe procedural penal; (iii) kryerjen e shkeljes disiplinore nga ana e magjistratit me dashje direkte; (iv) pasojat e shkeljes disiplinore, lidhur me lirin e një të dënuari të rrezikshëm, i cili përbën rrezik për komunitetin dhe shoqërinë, në kundërshtim me parashikimet e legjislacionit material dhe procedural penal; (v) cenimin e imazhit të sistemit gjyqësor dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë; si dhe (vi) mungesën e ndonjë arsye specifike që është jashtë kontrollit të magjistratit dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e sistemit gjyqësor; faktin që shkelja disiplinore në rastin konkret përbën ‘Shkelje shumë të rënda disiplinore’; provohet se magjistrati {...} në vendimmarrjen e tij ka kryer shkelje të rënda profesionale duke diskretitur rëndë figurën dhe pozitën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës”.
51. Në përfundim, Këshilli i lartë Gjyqësor, duke vlerësuar se veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga ana e ankuesit, përbëjnë “Shkelje shumë të rënda disiplinore” dhe që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës, ka vendosur dhënien e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”, e parashikuar në nenin 140, pika 2, shkronja “a” të Kushtetutës dhe në nenin 111 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
52. Në analizë të sa më sipër, Kolegji, duke pasur në konsideratë rrethanat e çështjes, ndan të njëjtin qëndrim si KLGj-ja për sa i përket llojit të shkeljes duke e konsideruar atë një shkelje shumë të rëndë disiplinore. Një sjellje e tillë në zbatimin e ligjit në rastin e një gjyqtari me eksperiencë të gjatë në sistemin e drejtësisë dhe me njohuri të plota në zbatimin e legjislacionit penal apo përdorimi i bindjes së brendshme si një mekanizëm mbrojtës ndaj çdo kontrolli të një trupe gjykuese apo të një trupe disiplinore, konsiderohen prej Kolegjit se kanë diskredituar pozitën dhe

figurën e gjyqtarit, në kuptim të parashikimit kushtetues të nenit 140, si dhe në frymën e qëndrimit të Gjykatës Kushtetuese se *shprehja “akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën...”, [...] përmbledh në vetvete një sërë elementesh, [...] të lidhura me aktet dhe sjelljet e parregullta e të padenja që këta funksionarë të lartë kryejnë gjatë ushtrimit të detyrës, për shkak të saj, por edhe jashtë detyrës. Këto veprime apo mosveprime që analizohen në bazë të rrethanave të kryerjes së tyre, momentit subjektiv, si dhe nga dëmet që ato i sjellin shoqërisë e shtetit, janë të asaj natyre që e bëjnë të pamundur kryerjen e mëtejshme të funksioneve kushtetuese nga këto subjekte³”.*

53. Kolegji e gjen të drejtë arsyetimin që ka bërë Këshilli në lidhje me elementët që kanë përcaktuar vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra dhe nuk konstaton elementë të tjerë qoftë faktikë apo ligjorë që do e çonin Kolegjin në një vlerësim të ndryshëm.
54. Gjithashtu, Kolegji vlerëson se masa disiplinore e vendosur ndaj ankuesit është proporcionale me shkeljet e kryera prej tij në dhënien e drejtësisë, të cilat konsiderohen si akte dhe sjellje që diskreditojnë rëndë figurën e gjyqtarit.
55. Në vlerësimin tërësor të çështjes, Kolegji bazohet në qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese, e cila në analizë të standardeve kushtetuese për pavarësinë dhe përgjegjësinë e gjyqtarëve, bazuar në praktikën e vetë gjykatës, si dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së, është shprehur se: *“Pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave nuk është një qëllim në vetvete. Respektimi i këtij parimi është një kusht i nevojshëm për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. [...]Në këtë kuptim, kjo pavarësi nuk është një privilegj, por një nga detyrat themelore të gjyqtarëve dhe të gjykatës, që rrjedh nga të drejtat e njeriut për të pasur një arbitër të paanshëm në një konflikt, të garantuar nga Kushtetuta. Garantimi i një standardi të tillë përbën dhe kriterin orientues për të vlerësuar pavarësinë e gjyqtarëve dhe të gjykatave⁴”.*
56. Për sa më sipër, Kolegji, bazuar në analizën në tërësi të pretendimeve të ankuesit, i gjen ato të pabazuara e, për pasojë, ankimin e tij, për shfuqizimin e vendimit nr. 633, datë 10.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si të papranueshëm.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në mbështetje të nenit 179, pika 7, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 71, pika 3 e ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

³ Vendimi nr.75/2002, i Gjykatës Kushtetuese.

⁴ Vendimi nr.11/2008, i Gjykatës Kushtetuese.

VENDOSI:

Mospranimin e ankimit të z. Markelian Kuqo, kundër vendimit nr. 633, datë 10.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për caktimin e masës disiplinore ndaj gjyqtarit Markelian Kuqo”.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë, dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më datë 07.12.2022.

Shpallur më datë 06.01.2023.

KRYETARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

GJYQTARE

Ina RAMA

nënshkrimi - kundër

GJYQTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi - kundër

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

GJYQTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

GJYQTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

MENDIM NË PAKICË

Ne gjyqtaret **Ina Rama** dhe **Mimoza Tasi** kemi votuar në ndryshim nga shumica e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim Kolegji), për shfuqizimin e vendimit nr. 633, datë 10.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, objekt ankimi, i cili ka vendosur për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të magjistratit Markelian Kuqo. Sipas vlerësimit tonë, ndonëse provohet se magjistrati ka kryer shkelje profesionale në zgjidhjen e çështjes që i përket kërkuesit G. Gj., me objekt lirim para kohe me kusht, me vendimin nr. {***}, datë 14.02.2019, të dhënë prej tij si gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, ato nuk vlerësohen se janë të një niveli të tillë që të plotësojnë kondicionin kushtetues të “shkeljes së rëndë”, sipas parashikimit të nenit 140 të Kushtetutës. Për pasojë, shkarkimi nga detyra i ankuesit, mbështetur në këto shkelje, nuk konsiderohet si proporcional dhe nuk justifikon ndëshkimin disiplinor të duhur sipas parashikimit kushtetues. Në këto rrethana, kemi vlerësuar se shfuqizimi i vendimit të KLGj-së dhe kthimi i çështjes organit administrativ për ta rishqyrtuar dhe për të vendosur një masë tjetër disiplinore, do të ishte zgjidhja e drejtë për rastin objekt gjykimi. Këto konkluzione të përgjithshme i bazojmë në arsyetimin e mëposhtëm.

1. Neni 140, pikat 1 dhe 2, i Kushtetutës së Shqipërisë parashikon se: *“1. Gjyqtari mban përgjegjësi disiplinore, sipas ligjit. 2. Gjyqtari shkarkohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor kur: a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës; [...]”*. Në kushtet kur ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën e Kolegjit se është pikërisht kjo dispozita kushtetuese, sipas së cilës KLGj-ja mund të vendoste shkarkimin nga detyra të magjistratit dhe jo neni 102, pika 2, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 96/2016, shfuqizuar me vendimin nr. 34, datë 10.04.2017, të Gjykatës Kushtetuese në kohën e kryerjes së shkeljes, kemi ndarë mendimin se nën dritën e kësaj dispozite duhej të përcaktohej rëndësia e shkeljes dhe nëse ajo mund të kualifikohej si e rëndë dhe që ka diskretituar pozitën dhe figurën e gjyqtarit.
2. Shkelja e parë e atribuar ankuesit, si nga KLGJ-ja, ashtu edhe nga shumica e Kolegjit, është konsideruar zbatimi i gabuar i nenit 65 të Kodit Penal, lidhur me veprimin e tij në kohë dhe mospasja në konsideratë në përcaktimin e këtij veprimi të vendimit unifikues nr. 4/2003, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Këtë qëndrim rezulton të ketë mbajtur edhe Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. {***}, datë 26.06.2019, që ka ndryshuar vendimin e dhënë nga magjistrati. Të njëjtin qëndrim, ndonëse jo në referim të vendimit unifikues nr. 4/2003, ka mbajtur edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin nr. {***}, datë 14.06.2022, me të cilin ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit Korçë. Sipas këtij qëndrimi magjistrati duhet të kishte aplikuar kriterin objektiv të vuajtjes së dënimit jo më pak se 35 vjet nga i dënuari, sipas parashikimit të nenit 65 të Kodit Penal, të ndryshuar, me ligjin nr. 37/2017 dhe jo të konsideronte parashikimin për vuajtjen e jo më pak se 25 vjet burgim, sipas përcaktimit që neni 65 i Kodit Penal kishte para ndryshimeve dhe që përkonte me kohën e kryerjes së veprës penale nga i dënuari, kohën e gjykimit në Itali, por edhe kohën e njohjes së vendimit penal të huaj në vitin 2014 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë para transferimit të tij në Shqipëri.

3. Sipas vlerësimit të pakicës, ndonëse *a prima facie*, duket se magjistrati ka zbatuar gabim dispozitën, duke përcaktuar kriterin objektiv të vuajtjes së dënimit mbi 25 vjet, sipas parashikimit të dispozitës penale para ndryshimeve ligjore, qëndrim i mbajtur edhe nga Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, rrethanat e zbatimit në këtë mënyrë të ligjit penal, e relativizojnë nivelin e shkeljes së ligjit nga ana e magjistratit.
4. Së pari, vendimi i dhënë nga ankuesi, objekt i këtij procedimi disiplinor, rezulton të jetë i pari i këtij lloji në vend i dhënë nga gjykatat. Që nga miratimi i Kodit Penal në vitin 1995, nuk rezulton asnjë rast tjetër në të cilin gjykatat shqiptare të kenë trajtuar institutin e lirimit para kohe me kusht për të dënuarit me burgim të përjetshëm edhe për shkak të mosplotësimit të kriterit objektiv të vuajtjes së dënimit prej 25 vitesh që prej miratimit të Kodit. Në këtë terren të pashkelur nga pikëpamja e praktikës gjyqësore është dhënë vendimi objekt procedimi disiplinor. Kjo rrethanë, në vlerësimin tonë si gjyqtare në pakicë, duhet të konsiderohet në tërësi në përcaktimin e gravitetit të shkeljes së ligjit prej magjistratit.
5. Së dyti, nuk jemi dakordësuar me qëndrimin se përcaktimi i kriterit objektiv për vuajtjen e dënimit prej 25 vitesh vjen në kundërshtim me vendimin unifikues nr. 4/2003. Në vlerësimin tonë, vendimi unifikues i Kolegjeve të Bashkuara unifikon zbatimin e fuqisë prapavepruese të normës penale favorizuese në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale, duke përcaktuar se dispozita penale favorizuese nuk mund të afektojë dënimin e dhënë tashmë me vendim të formës së prerë, kur ai është në fazën e ekzekutimit të vendimit. Sipas arsytimit të vendimit unifikues nr. 4/2003, ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese vetëm për çështje që janë ende në gjykim dhe jo pasi vendimi i dënimit ka marrë formë të prerë⁵, përcaktim i cili duket jorelevant në rastin e gjykuar prej magjistratit, në të cilin, pikërisht, ligji penal i mëpasshëm nuk është favorizues por rëndues. Në rastin konkret, magjistrati, ka zbatuar ligjin penal, nenin 65 të Kodit Penal të kohës së kryerjes së veprës, dënimit të të dënuarit nga gjykata e huaj dhe njohjes së këtij vendimi nga gjykata shqiptare, në zbatim të nenit 3, pika 3 e Kodit Penal, por jo duke i dhënë fuqi prapavepruese një norme penale, por duke aplikuar sipas vlerësimit të tij, ligjin e kohës kur është dënuar kërkuesi. Në këto kushte, pavarësisht aplikimit të gabuar ose jo të normës së duhur penale, kemi gjykuar se vendimi unifikues nr. 4/2003 është jorelevant me çështjen që ka pasur për zgjidhje magjistrati. Për këtë arsye, nuk mund të konsiderohet se magjistrati ka vepruar në kundërshtim me këtë vendim unifikues, në kuptim të kualifikimit të vendimmarrjes së tij si shkelje disiplinore. Në të njëjtën linjë gjendet edhe arsyetimi i Gjykatës së Lartë në vendimin nr. {***}, datë 14.06.2022, që zgjidh çështjen objekt disiplinor, në të cilin nuk ka një konkluzion të qartë rreth zgjidhjes së çështjes në kundërshtim me vendimin unifikues nr. 4/2003, por arsyeton, ndër të tjera, se zbatimi i ligjit në mënyrën që e ka zbatuar magjistrati është jashtë logjikës juridike⁶.

⁵ Megjithatë, duhet vënë në dukje fakti që fuqia prapavepruese e ligjit penal favorizues, në raport me momentin kohor të zbatimit të tij, nuk është e pakufizuar, pasi ky moment është i kushtëzuar nga faza në të cilën gjendet procedimi penal që i përket personit të akuzuar për kryerjen e veprës penale, fazë e cila, duke u bazuar në sa u thanë me hollësi më lart, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se nuk mund të jetë tej momentit kohor kur vendimi i dënimit penal të personit të akuzuar ka marrë formë të prerë, gjë që vlen edhe për personat e dënuar me vendim penal të formës së prerë të gjykatave të huaja penale, sikurse është rasti objekt gjykimi.

⁶ 92. Kolegji vlerëson se në pretendimin për të përfutur lirimin me kusht nuk gjen zbatim parimi i ligjit penal favorizues, parashikuar nga neni 3/3 i Kodit Penal. Ky parim gjen zbatim për ligjin penal material që zbaton gjykata e themelit kur gjykon çështjen penale në ngarkim të të pandehurit. Në kushtet kur kërkuesi pretendon lirim me kusht,

6. Në këto rrethana, konkluzioni ynë, si gjyqtare në pakicë, është se vendimi objekt procedimi disiplinor i marrë prej magjistratit nuk është në kundërshtim me vendimin unifikues nr. 4/2003, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke qenë se unifikimi i praktikës së synuar me vendimin e mësipërm nuk mund të afektojë zgjidhjen e çështjes që ka pasur në shqyrtim magjistrati, për shkak të situatave të ndryshme faktike e ligjore që konstatohen në këtë vendim, në raport me ato që unifikon vendimi i Kolegjeve të Bashkuara. Në konkluzion, në ndryshim nga arsyetimi i KLGJ-së dhe i konfirmuar nga shumica e Kolegjit, ne nuk kemi konsideruar se ankuesi ka kryer shkelje disiplinore për këtë shkak.
7. Së treti, në kushtet e mungesës së interpretimit të dispozitës penale nga ndonjë prej gjykatave në vend, në kohën e marrjes së vendimit objekt procedimi disiplinor, magjistrati rezultoi t'i jetë drejtuar për referim jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut, si pjesë integrale e KEDNj-së dhe si një prej burimeve të së drejtës në vend, në zbatim të nenit 116, pika 1, shkronja "b" e Kushtetutës. Në çështjen e referuar në vendimin e ankuesit, objekt i procedimit disiplinor, *Del Ria Prada kundër Spanjës*, vendim i dhënë nga Dhoma e Madhe në GjEDNj, rezultoi se është trajtuar në kuadër të shkeljes së nenit 7 të KEDNj-së, fakti i ndryshimeve të mëposhme të rregullave, për shkak të interpretimeve të kryera nga gjykata supreme e vendit, që rëndonin pozitën/dënimin e një të dënuar me 30 vjet burgim, në raport me atë që ajo kishte në kohën e përcaktimit të dënimit të saj. Sipas qëndrimeve të mbajtura në këtë vendim nga Gjykata e Strasburgut, duket se ajo kërkon një vlerësim të dedikuar të rasteve të tilla, kur garancitë e të dënuarve apo pritshmëritë e tyre për ekzekutimin e një vendimi penal dënim, cenohen apo reduktohen për shkak të ndërhyrjeve të ligjvënësive apo qëndrimeve të gjykatave më të larta që unifikojnë rregullat. Në këto raste, orientoni ky vendim i gjykatës, është e rëndësishme të evidentohet nëse ndërhyrjet janë të një natyre dhe niveli që vetëm demonstronjë vullnetin shtetëror për mënyrën e ekzekutimit të dënimit penal apo pasojat që ato prodhojnë janë aq të rëndësishme për të dënuarin saqë mund të konsiderohen se kanë modifikuar fushëzbatimin e dënimit të caktuar, duke vendosur në këtë mënyrë një dënim të ri penal, situatë e cila do të konsiderohej si shkelje e nenit 7 të KEDNj-së⁷. Në rastin e shqyrtuar prej saj, Gjykata ka konkluduar se e ashtuquajtura "Doktrina Parot", nëpërmjet masave të marra që kanë cenuar lehtësimet e kërkueses në vuajtjen e dënimit penal, ka modifikuar fushëveprimin e dënimit të caktuar në dëm të saj, duke shkaktuar në këtë mënyrë shkelje të nenit 7 të KEDNj-së⁸.

gjykata do të zbatojë ligjin që është në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës, duke zbatuar kushtet dhe kriteret që kërkon dispozita penale konkrete. Kolegji vlerëson se është jashtë logjikës juridike që për lirimin me kusht të zbatohet ligji i kohës kur është kryer vepra penale, pasi instituti i liritimit me kusht nuk ka lidhje me kohën e kryerjes së veprës penale.

⁷ Paragraf 116 [...] Në këtë aspekt, ndërkohë që Gjykata e pranon që Shtetet janë të lira të përcaktojnë politikat e veta penale, për shembull duke rritur dënimet e zbatueshme për vepra penale (shih Achour, cituar lart, § 44), ato duhet të veprojnë në pajtim me kërkesat e nenit 7 kur e bëjnë këtë (Maktouf dhe Damjanović kundër Bosnje dhe Hercegovinës [GC], nr. 2312/08 dhe nr. 34179/08, § 75, 18 korrik 2013). Në lidhje me këtë pikë, Gjykata përsërit që neni 7 i Konventës në mënyrë të pakushtëzuar ndalon zbatimin prapaveprues të së drejtës penale aty ku ai është në disavantazh të të akuzuarit

⁸ 117. Duke pasur parasysh ato që u thanë më lart, Gjykata konsideron që në kohën kur kërkuesja është dënuar dhe në kohën kur ajo është njoftuar në lidhje me vendimin për kombinimin e dënimeve të saj dhe caktimin e një afati maksimal të burgimit, nuk ka pasur tregues të ndonjë linje të perceptueshme të zhvillimeve të praktikës gjyqësore në përputhje me vendimin e Gjykatës Supreme të 28 shkurtit 2006. Prandaj, kërkuesja nuk ka pasur arsye të besonte që Gjykata Supreme do të ndryshonte praktikën e saj gjyqësore dhe që, për pasojë, Audiencia Nacional do të zbatonte

8. Në këto rrethana, të përshkruara më lart, pakica ka vlerësuar se duhet të matet edhe graviteti i shkeljes disiplinore, që lidhet me zbatimin e gabuar të ligjit, për sa i përket përcaktimit të veprimit në kohë të nenit 65 të Kodit Penal. Rrethanat e mësipërme, në mungesë të jurisprudence së brendshme për raste të ngjashme, moszbatimit të vendimit unifikues nr. 4/2003 në çështjen objekt shqyrtimi nga magjistrati, orientimit të Gjykatës së Strasburgut drejt një analize të tillë të ndryshimeve ligjore që kanë rënduar pozitën e të dënuarit, pavarësisht qëndrimit të mbajtur nga Gjykata e Lartë se në rastin konkret magjistrati e ka zbatuar gabim ligjin, në vlerësimin tonë zbehin peshën dhe rëndësinë e shkeljes së ligjit të kryer prej tij në kuadër të këtij procedimi disiplinor.
9. Lidhur me shkeljen disiplinore referuar mozbatimit të qëndrimit unifikues të vendimit nr. 2/2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ne gjyqtaret në pakicë kemi ndarë mendimin se orientimet e dhëna në këtë vendim lidhur me “arsyet e veçanta” të parashikuara në nenin 64 të Kodit Penal, nuk mund të konsiderohen se janë detyruese për magjistratët që shqyrtojnë çështjet me objekt kërkimi lirim para kohe me kusht për të dënuarit me burgim të përjetshëm. Në këtë drejtim, sipas vlerësimit tonë, këto dispozita, neni 64 dhe neni 65 i Kodit Penal, ndonëse rregullojnë të njëjtin institut, lirimin para kohe me kusht, janë autonome për sa u përket kushteve dhe kriterëve në të cilat ato do të zbatohen, përderisa u referohen dy llojeve të ndryshme të dënimeve, në kuptim të nenit 29 të Kodit Penal, dënimit me burgim të përjetshëm, sipas paragrafit të parë, pika 1 dhe dënimit me burgim, sipas paragrafit të parë, pika 2. Për më tepër që në krye të nenit 65 të Kodit Penal shpallet qëndrimi i ligjvënësit se lirimi para kohe me kusht për të burgosurin me burgim të përjetshëm nuk lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme, ndryshe nga qëllimi i shpallur në nenin 64 se lirimi para kohe me kusht për të dënuarit me burgim, mund të lejohet nëse ekzistojnë arsyet e veçanta që kanë dëshmuar rehabilitimin e tij. Gjithashtu, vetë dispozitat kanë përcaktuar rrethanat specifike që duhen plotësuar në secilin rast për t’u aplikuar ky institut. Në këtë kuptim, orientimi unifikues që Kolegjet e Bashkuara kanë bërë për “arsyet e veçanta”, sipas nenit 64 të Kodit Penal, nuk duhet të konsiderohet detyrues për zbatim për magjistratët që gjykojnë çështjet e lirimit para kohe me kusht, për të dënuarit me burim të përjetshëm. Padyshim që arsyetimi dhe fryma e përcjellë me këtë vendim unifikues duhet të jenë referim për magjistratët në zbërthimin autonom të rasteve të jashtëzakonshme të parashikuara në nenin 65 të Kodit Penal, në mungesë të një jurisprudence orientuese për këtë dispozitë. Mosreferimi në arsyet e veçanta që rendit vendimi unifikues nr. 2/2015, nuk konsiderohet prej nesh se prodhon një shkelje të ligjit që passjell përgjegjësinë disiplinore. Në të njëjtën frymë me arsyetimin e mësipërm është edhe vendimi i Gjykatës së Lartë me nr. {***}, datë 14.06.2022, i cili nuk e bazon qëndrimin e tij për padrejtësinë e vendimit të marrë prej magjistratit në ardhjen në kundërshtim me këtë vendim unifikues, por bën një vlerësim të përgjithshëm të rastit të jashtëzakonshëm në mënyrë hipotetike⁹.

lehtësimet e dënimit të saj jo ndaj afatit maksimal me tridhjetë vjet burg që duhet të vuante, por respektivisht ndaj secilit prej dënimeve që ajo kishte marrë. Siç ka vërejtur Gjykata lart (shih paragrafët 109 dhe 111), ky ndryshim në praktikën gjyqësore pati efektin e modifikimit të fushëveprimit të dënimit të caktuar, në dëm të kërkuases.

⁹ 84. Kolegji thekson se rastet e jashtëzakonshme të kërkuara nga ligjvënësi për lirimin me kusht për të dënuarin me burgim të përjetshëm nuk mund të barazohen me arsyet e veçanta që kërkohen për lirimin me kusht për të dënuarin me burgim, të interpretuara në vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara nr. 2, datë 25.05.2015. [...] 85. Për të dënuarin me burgim të përjetshëm ligjvënësi kërkon ekzistencën e rasteve të jashtëzakonshme, të cilat në kuptim të

10. Për sa më sipër, kemi vlerësuar se edhe konkluzioni i KLGj-së, se ankuesi ka kryer shkelje disiplinore se ka zgjidhur çështjen në kundërshtim me vendimin unifikues nr. 2/2015, nuk është një konkluzion i saktë dhe i bazuar.
11. Ne gjyqtaret në pakicë kemi ndarë një qëndrim të ndryshëm nga shumica edhe për sa i përket konsiderimit të të qenurit përsëritës për të dënuarin, si një rrethanë e cila duhej të konsiderohej si ndaluese për aplikimin e nenit 65 të Kodit Penal. Ky qëndrim, i mbajtur edhe nga KLGj-ja, por edhe nga Gjykata e Lartë, është parë i pavend prej nesh, pikërisht në vijim të arsyetimit të mbajtur më lart se dy dispozitat, nenet 64 e 65 të Kodit Penal, janë autonome e meritojnë të zbatohen drejtpërdrejtë dhe jo me analogji. Në nenin 64, paragrafi i tretë i Kodit Penal parashikohet se: *“Nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje, si dhe për të dënuarit për kryerjen e veprave penale të parashikuara në nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c, apo paragrafi i tretë i nenit 100”*, ndërsa në nenin 65, paragrafi i tretë i tij, parashikohet se: *“Nga ky rregull, përjashtohen të dënuarit për veprat penale të parashikuara në nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c dhe paragrafi i tretë i nenit 100”*. Nga leximi i këtyre dy dispozitave, konstatohet lehtësisht se të qenurit përsëritës për një krim të kryer me dashje nuk është renditur si një kriter ndalues në kushtet e parashikuara në nenin 65 të Kodit Penal. Për pasojë, zbatimi me analogji i nenit 64 dhe kriterëve të tij ndaluese në rastet e parashikuara nga neni 65 i Kodit Penal do të vinte në kundërshtim me parimin e parashikuar nga neni 1/c i Kodit Penal, sipas së cilit *zbatimi i ligjit penal me analogji nuk lejohet*. Për këto arsye, moskonsiderimi i të qenurit përsëritës për të dënuarin G. Gj., meqenëse ka kryer edhe veprën penale të falsifikimit të monedhave, si një kriter ndalues për përfitimin prej tij të lirit para kohe me kusht, është vlerësuar prej nesh si jo në përputhje me ligjin.
12. Në terma të ngjashëm jemi dakordësuar me shumicën e trupit gjykues për sa i përket, konsiderimit të rastit konkret si një rast të jashtëzakonshëm, i cili në vlerësimin tonë është kryer nga ankuesi si pasojë e një hetimi të pathelluar dhe i një vlerësimi sipërfaqësor të fakteve që kanë rezultuar nga provat e administruara. Të gjithë elementët e përshkruar më lart lidhen edhe me arsyet e veçanta, por edhe me rrethanën e të qenurit përsëritës, ndonëse nuk kanë qenë kriter ndalues në kuptim të arsyetimit më lart, sigurisht që duhet të bënë pjesë në gjykimin që magjistrati duhej t'i kishte bërë rastit në fjalë. Arsyetimi i tij, mbi rrethanat konkrete të pasqyruara në vendim, nuk është kryer sipas një standardi të arsyeshëm të termit “rast i jashtëzakonshëm”, i përdorur nga ligjvënësi e që do të justifikonte lirin para kohe me kusht për të dënuarin G. Gj.
13. Në përmbledhje të sa më lart, kemi gjykuar se ankuesi ka kryer shkelje profesionale për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit e vlerësimit jo në frymën e ligjit të rastit të jashtëzakonshëm, si një rast

ligjit janë ato raste të rralla dhe që çmohen prej gjykatës, si jo vetëm të jashtëzakonshme, por edhe që për rëndësinë që kanë për ligjin lirin me kusht të të dënuarit me burgim të përjetshëm, në rast se ai plotëson edhe kushtet e tjera që kërkon dispozita, ka vuajtur jo më pak se tridhjetë e pesë vjet burgim dhe gjatë vuajtjes së dënimit ka mbajtur sjellje shembullore dhe çmohet se i është arritur qëllimit të dënimit për edukimin e tij. Raste të tilla të jashtëzakonshme do të përbënin një sëmundje e rëndë e të dënuarit ose rrethana të tjera objektive, të provuara përpara gjykatës që, pavarësisht masës maksimale të dënimit me të cilin i dënuari është dënuar, i japin atij të drejtën të përfitojë nga lirimi me kusht. Gjithsesi, Kolegji çmon se rastet e jashtëzakonshme nuk përfshihen tek arsyet e veçanta dhe ato duhet të analizohen dhe argumentohen prej gjykatës që vendos në lidhje me lirin me kusht.

përrjashtimor që do të justifikonte lirimin para kohe me kusht të një të dënuari me burgim të përrjetshëm.

14. Pavarësisht këtij konkluzioni, sipas vlerësimit tonë, shkeljet e kryera nga ankuesi në rrethanat e lartpërrmendura të: (i) mungesës së qartësisë për zbatimin në kohë të normës penale; (ii) mungesës së definicioneve apo orientimeve të jurisprudencës për kriteret që do të përrkufizonin rastin e jashtëzakonshëm; (iii) vlerësimit të rrethanave të çështjes sipas diskrecionit e bindjes së brendshme të vetë gjyqtarit; (iv) mosardhjes në kundërshtim me vendimet unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara, sipas një qëndrimi ekspllicit në vendimin e Gjykatës së Lartë; (v) mosshkeljes së kriterit ndalues që lidhet me përrsëritjen në kryerjen e një veprë penale; (vi) konstatimit të shkeljeve disiplinore në një çështje të vetme përrgjatë gjithë kohës së ushtrimit të funksionit, pavarësisht kontrollit tematik të ushtruar nga ILD-ja në gjykatën ku ankuesi ushtron funksionet; (vii) moskonsiderimit të faktit që i dënuari është larguar dhe nuk është bërë i mundur ekzekutimi i vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë për kthimin e tij në vendin e vuajtjes së dënimit si një pasojë e rëndë që ka ardhur nga vendimi objekt shqyrtimi disiplinor, por nga mosfunksionimi i hallkave të tjera shtetërore që mbikëqyrin ekzekutimin e vendimeve penale, na çojnë në konkluzionin se ato nuk mund të konsiderohen si shkelje haptazi dhe në kundërshtim flagrant me ligjin dhe, për pasojë, të kualifikohen si shkelje të rënda profesionale, sipas parashikimit të nenit 140 të Kushtetutës.
15. Në këtë konkluzion, pakica ka mbajtur në konsideratë edhe qëndrimet e konsoliduara të Gjykatës Kushtetuese sipas të cilave, shkelja e rëndë, sipas përrcaktimeve kushtetuese, duhet të jetë e një niveli që e bën gjyqtarin të padenjë për të qenë pjesë e sistemit të drejtësisë.
16. Në mbështetje të këtij arsytimi, pakica sjell në vëmendje qëndrimet e mbajtura nga Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr.17/2004, ku, ndër të tjera, ka arsytuar se: *Këshilli i Lartë i Drejtësisë, duke mos iu referuar shkaqeve kushtetuese që parashikohen në nenin 147 të Kushtetutës, ka cenuar drejtpërrsëdrejti mbrojtjen kushtetuese të gjyqtarit, si dhe të drejtën e tij për një proces të rregullt ligjor. Ky organ, duke vlerësuar si shkak për shkarkim nga detyra të gjyqtarit mënyrën e gabuar të zbatimit të dispozitave materiale e procedurale për çështje konkrete në gjykim, jo vetëm ushtron atributë që nuk i përrkasin, por ndërhyr drejtpërrsëdrejti në objektivitetin dhe pavarësinë e gjykatës. Gjykata Kushtetuese thekson se gjyqtari nuk mund të shkarkohet nga detyra për mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, për sa kohë që nga rrethanat objektive dhe subjektive nuk rezulton se veprimet e tij mund të kenë qenë të qëllimshme dhe në kundërshtim të hapët dhe flagrant me ligjin apo me praktikën unifikuese të gjykatave më të larta.*
17. Ndërsa në Vendimin nr. 11/2008, Gjykata Kushtetuese, ndër të tjera, ka arsytuar se: *Këshilli i Lartë i Drejtësisë, duke mos iu referuar shkaqeve kushtetuese që parashikohen në nenin 147 të Kushtetutës, ka cenuar drejtpërrsëdrejti mbrojtjen kushtetuese të gjyqtarit, si dhe të drejtën e tij për një proces të rregullt ligjor. Ky organ, duke vlerësuar si shkak për shkarkim nga detyra të gjyqtarit mënyrën e gabuar të zbatimit të dispozitave materiale e procedurale për çështje konkrete në gjykim, jo vetëm ushtron atributë që nuk i përrkasin, por ndërhyr drejtpërrsëdrejti në objektivitetin dhe pavarësinë e gjykatës. [...] Gjykata Kushtetuese thekson se gjyqtari nuk mund të shkarkohet nga detyra për mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, për sa kohë që nga rrethanat objektive dhe subjektive nuk rezulton se veprimet e tij mund të kenë qenë të qëllimshme dhe në kundërshtim të hapët dhe flagrant me ligjin apo me praktikën unifikuese të gjykatave më të larta.*

18. Në vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, ndonëse i marrë në funksion të kontrollit kushtetues mbi një ligj që rregullon një proces të jashtëzakonshëm kontrolli, siç është procesi i rivlerësimit, i shoqëruar me kufizime të shprehura që në Aneksin e Kushtetutës të disa të drejtave, përsëri, Gjykata ka potencuar idenë e trajtimit të aftësive profesionale të magjistratëve, me kujdesin e moscenimit të pavarësisë së tyre, duke arsyetuar se: *Në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, Gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht “të pasakta” nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (shih edhe opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias).* Ky standard i vendosur nga Gjykata Kushtetuese për procesin e rivlerësimit, aq më shumë duhet të garantohet për magjistratët në rastet e procedimeve disiplinore ndaj tyre sipas juridiksionit të përgjithshëm.
19. Në mbështetje të sa u arsyetua më lart, në mënyrë të detajuar në këtë mendim pakice, ne kemi konkluduar se shkeljet profesionale të konstatuara në vendimin objekt i shqyrtimit disiplinor, nuk mund të konsiderohen si shkelje të rënda profesionale, të tilla që të justifikojnë marrjen e masës ekstreme disiplinore të shkarkimit nga detyra për magjistratin. Për këto arsye, vendimi i KLGJ-së që ka vendosur marrjen e kësaj mase duhet të shfuqizohet si i pambështetur në Kushtetutë e në ligj.
20. Duke qenë se Kolegji është gjykata e vetme që shqyrton ankimet ndaj vendimeve për procedimet disiplinore të Këshillave, sipas parashikimit të nenit 179, pika 7 e Kushtetutës, kemi vlerësuar se për shkak të juridiksionit kontrollues gjyqësor mbi vendimet e Këshillave, në këtë rast duhet t'i takojë KLGJ-së detyra e rishqyrtimit të procedimit disiplinor ndaj magjistratit për të konkluduar sipas trajtimit të mësipërm të rrethanave se shkeljet profesionale janë kryer nga magjistrati, por jo në nivelin e shkeljeve të rënda dhe nën dritën e konkluzioneve të arrira më lart të caktojë brenda kufijve të diskrecionit të tij marrjen e një mase disiplinore të përshtatshme e proporcionale në raport me shkeljet e pranuar se kanë ndodhur.

GJYQTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

GJYQTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi